

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. nr. 59/2014

20 prill 2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, me Trupin Gjykses të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Paulo Teixeira, si Kryetar i Trupit Gjykses, dhe gjyqtarët e EULEX-it Nuno Manuel Ferreira de Madureira dhe Franciska Fiser, si anëtarë të Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjorë të EULEX-it Vera Manuello, si procesmbajtëse, në çështjen penale P. nr. 59/2014:

Kundër:

R. R. (nofka K.), i lindur më _____, në _____, _____ i Kosovës, emri i babait Z., profesioni: _____, dikur me banim në _____, Kosovë, i martuar, numri i pasaportës ose i letër-njoftimit _____, numri i lejes së vozitjes _____; aktualisht në paraburgim;

dhe

M. "D." V. (nofka J.), i lindur më _____, në Mitrovicë, _____ i Kosovës, emri i babait D., profesioni: _____, aktualisht me banim në _____, Rruga Nr. __, __, Kosovë, i martuar, numri i letër-njoftimit _____; aktualisht në lirim me dorëzani;

Të akuzuar përmes Aktakuzës së Prokurorit të Shtetit në Mitrovicë, e datës 7 maj 2014, dhe e depozituar në Shkrimtore më 8 maj 2014, me këto veprat penale:

1. **Vrasje e rëndë**, në shkelje të neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të Kodit Penal të Kosovës, RREG/UNMIK 2003/25 (KPK), lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr 04/L-082 (KPRK), lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
2. **Vrasje e rëndë në tentativë**, në shkelje të neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK-së, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së;

3. **Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve**, në shkelje të nenit 328 (1) dhe (2) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 374 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
4. **Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare**, në shkelje të nenit 316 (1) dhe (3) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 409 (1) dhe (2) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
5. **Rrezikim i trafikut publik me veprim apo me mjeteve të rrezikshme**, në shkelje të nenit 299 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
6. **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm**, në shkelje të nenit 291 (1), (3) dhe (5) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;
7. **Pjesëmarrje në grup që kryen veprë penale**, në shkelje të nenit 320 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 412 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të gjitha të hapura për publikun, më 19 (e pezulluar), 20 dhe 29 janar 2015, 27 shkurt 2015, 09, 12, 17, 18, 20 dhe 23 mars 2015, 01 dhe 16 prill 2015, në prani të Prokurorit, të akuzuarit R. R., mbrojtësve të tij Zhivojin Jokanoviç dhe/ose Nebojsa Vlajiç, të akuzuarit M. V., mbrojtësit të tij Agim Lushta, përfaqësuesit të viktimave Burhan Maxhuni, dhe palëve të dëmtuara D. Z. dhe D. P.,

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor, të mbyllura për publikun, më 29 janar 2015 në orën 15:27 deri në orën 15:50, dhe më 30 janar 2015, në prani të Prokurorit, të akuzuarit R. R., mbrojtësve të tij Zhivojin Jokanoviç dhe/ose Nebojsa Vlajiç, të akuzuarit M. V., mbrojtësit të tij Agim Lushta, përfaqësuesit të viktimave Burhan Maxhuni, dhe palëve të dëmtuara D. Z. dhe D. P.,

Pas dëgjimit të fjalëve përfundimtare të palëve më 16 prill 2015,

Duke pasur parasysh se Gjykata nuk është e detyruar t'i përmbahet kualifikimit ligjor të veprës penale të parashtruar në Aktakuzën e Prokurorisë, sipas Nenit 360 Paragrafi (2) të Kodit të Procedurës Penale, Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123 (KPPK), dhe që Gjykata mundet, sipas detyrës zyrtare, ta ri-kualifikojë veprën penale fillestare në veprë tjetër penale, të bazuar në fakte jo tërësisht në përputhje me ato të përshkruara në Aktakuzë, por që nuk përbëjnë një ndryshim thelbësor të rrethanave,

Pas shqyrtimit dhe votimi të trupit gjykues, të mbajtur më 19 dhe 20 prill 2015,

Brenda afatit të paraparë ligjor të përcaktuar në nenin 366 paragrafi (1) dhe nenin 446 paragrafi (4) të KPPK-së,

Në bazë të nenit 366 paragrafi (1) të KPPK-së, më 20 prill 2015, në seancë publike dhe në prani të të akuzuarve, mbrojtësve të tyre, Prokurorit të Shtetit, palëve të dëmtuara dhe përfaqësuesit të tyre,

Shqipton këtë:

AKTGJYKIM

I. I Akuzuari M. V., me të shënimet personale si më lart, nën Akuzën 1 është gjetur **JO FAJTOR**

Për shkak se **u provua** përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Më 26 korrik 2011, rreth orës 13:30, më shumë se pesëdhjetë (50) _____, pjesëtarë të _____, të cilët ishin në gatishmëri në bazën e _____ në Mitrovicë, e ndodhur në _____, morën urdhër të niseshin në drejtim të Portës 31, në mënyrë që të merrnin kontrollin e pikës kufitare. Autokolona e automjeteve të _____, pra, u nis nga baza e _____: autokolona përbëhej nga dy automjete të blinduara (njëri prej tyre kryesonte autokolonën dhe i dyti ishte në fund të autokolonës) dhe rreth 10-12 automjete të _____ ishin në mes të makinave të blinduara. Ndërsa lëvizte në drejtim të Portës 31, përgjatë rrugës kryesore të asfaltuar mes Mitrovicës dhe Zubin Potokut, në afërsi të fshatit Qabër, autokolona e _____ hasi barrikadën e parë të përbërë nga gurë dhe rërë, e cila pengonte autokolonën të vazhdonte më tej përgjatë rrugës kryesore. Prandaj, autokolona e _____ përdori një rrugë alternative/dytësore, me qëllim që të tejkalonte barrikadën, dhe pastaj hyri sërish në rrugën kryesore në drejtim të Portës 31.

2. Pasi vazhdoi rrugën për rreth 10 minuta, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupce, autokolona e _____ hasi një pengesë të dytë: këtë radhë një barrikadë e përbërë nga tre (3) automjete të vendosura në mes të rrugës. Pasagjerët dhe shoferët e tri automjeteve dolën nga makinat e tyre dhe filluan të përballen me _____, duke bërë gjeste dhe duke bërë gjeste në drejtim të tyre.

3. Rreth tetë (8) persona dolën nga automjetet dhe nisën të fjalosen me _____. Pak më vonë u afua edhe një automjet me dy (2) persona dhe u ndal në një distancë të caktuar nga barrikada. Disa _____ dolën nga automjetet e tyre dhe i urdhëruan (në gjuhën serbe dhe shqipe) personat të cilët bllokonin dhe pengonin magjistralen publike, që të hiqnin pengesat dhe të largonin makinat e tyre. Këta persona nuk iu bindën atij urdhri dhe vazhduan t'u ulërinin dhe bërtisnin _____, duke bërë gjeste dhe duke iu ngritur gishtat _____. Në këtë moment drejtuesi i operacioneve të _____ dha urdhër që mjete të blinduar të vazhdonte dhe të largonte automjetet e barrikadës. Sapo automjeti i blinduar iu afua automjeteve që kishin bllokuar rrugën, rreth tetë (8) personat të cilët po qëndronin prapa barrikadës, u larguan dhe u

futën në pyllin e vendosur në anën e majtë. Sapo këta persona u larguan nga barrikada, u dëgjua një e shtënë e parë e vetme zjarri dhe _____ të përfshirë në këtë operacion u informuan menjëherë se njëri prej tyre ishte plagosur rëndë. Menjëherë pas kësaj pasuan të shtëna të njëpasnjëshme nga ana e majtë, përballë autokolonës së _____.

4. Një plumb goditi fytyrën e viktimës dhe të dëmtuarit E. Z., pjesëtar i _____, i cili voziste automjetin e dytë të autokolonës së _____. Në momentin që u godit, automjeti i tij ishte i pozicionuar paralel me mjetin e blinduar që kryesonte autokolonën.

5. Pas të shtënës së parë që kishte goditur E. Z., filluan të shtëna të njëpasnjëshme kundër automjeteve të _____ nga tre drejtime të ndryshme dhe kjo zgjati për një periudhë të pacaktuar kohe jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) minuta. _____ iu kundërpërgjigjën me të shtëna, për të mbrojtur veten e tyre dhe për të marrë trupin e _____ të plagosur të _____, që u zhvendos në mjetin e blinduar. Të shtënat kundër autokolonës së _____ vazhduan deri sa autokolona u tërhoq duke lëvizur në drejtim të Mitrovicës.

6. Incidenti ndodhi në një pasdite vere me diell, kur moti ishte i mirë, me shikueshmëri të mirë.

7. z. F. U. ishte caktuar në automjetin e blinduar që kryesonte autokolonën e _____ drejt Portës 31. Dëshmitari, zoti F. U., ishte brenda automjetit të blinduar kryesues dhe distanca mes tij dhe kryerësve nuk u përcaktua në mënyrë të qartë, por nuk ishte më shumë se 20 metra nga barrikada.

8. Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:25, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupce të komunës së Zubin Potokut, një grup i papërcaktuar njerëzish vepruan duke privuar nga jeta E. Z. për motive raciste dhe kombëtare, për shkak të kombësisë së tij _____ dhe kosovare, në momentin kur E. Z. po zbatonte detyrën e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, ruajtjes së personave apo pronës, dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike, dhe duke vepruar kështu, rrezikuan me dashje jetën e pasagjerëve në veturë.

9. M. V. ishte plotësisht i aftë mendërisht.

Por gjithashtu nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D." V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të tyre të paligjshme, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur në privimin nga jeta të E. Z. për motive raciste dhe kombëtare, për shkak të kombësisë së tij _____ dhe kosovare, në kohën kur E. Z. po zbatonte detyrat e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, ruajtjes së personave apo pronës, dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike dhe duke vepruar kështu, rrezikuan me dashje jetën e pasagjerëve në veturë.

2. Se numri i automjeteve në barrikadë ose pranë barrikadës ishte më shumë se katër (4).
3. Se numri i personave në barrikadë ishte më shumë se rreth tetë (8).
4. Se i pandehuri dhe i bashkë-pandehuri po bllokonin dhe pengonin kalimin në magjistralen publike.
5. Se të shtënat zgjatën të paktën 20 minuta.

Prandaj **LIROHET NGA AKUZA** se ka kryer veprën penale të “vrasjes së rëndë”, në shkelje të neneve 146 dhe 147 paragrafët 4, 6, 8 dhe 10 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 1.5, 1.7, 1.9 dhe 1.10 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

2. I akuzuari M. V., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 2 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. “D” V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur në kryerjen e veprës penale të “vrasjes së rëndë në tentativë” për të privuar nga jeta udhëtarët e tjerë (_____ B. M. dhe D. P.), në veturë me palën e dëmtuar, të ndjerin E. Z., për motive raciste dhe kombëtare, për shkak të kombësisë së tij _____ dhe kosovare, në kohën kur E. Z. po zbatonte detyrat e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, ruajtjes së personave apo pronës, dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike, dhe duke vepruar kështu, ata rrezikuan me dashje jetën e _____ B. M., D. P. dhe _____ të tjerë të _____ në autokolonën e automjeteve në *locus in quo*.

Prandaj **LIROHET NGA AKUZA** se ka kryer veprën penale të “vrasjes së rëndë në tentativë” në shkelje të neneve 146 dhe 147 paragrafët 4, 6, 8 dhe 10 të KPK-së, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 1.5, 1.7, 1.9 dhe 1.10 të KPRK-së, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së.

3. I akuzuari M. V., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 3 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D."** V., në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur në kryerjen e veprës penale të "Mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", kishte nën kontroll dhe posedonte një armë të përdorur në vrasjen e rëndë të E. Z. në kundërshtim me ligjin në fuqi lidhur me këto lloj armësh.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të "mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve", në shkelje të nenit 328 paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 374 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

4. I akuzuari M. V., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 3 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D."** V., në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, përdorën forcë dhe kërcënime serioze për të penguar _____ në *locus in quo* në kryerjen e detyrave të ligjshme zyrtare të tyre.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të "pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare", në shkelje të nenit 316 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 409 (1) dhe (2) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

5. I akuzuari M. V., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 5 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D."** V., në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, shkatërroi, zhvendosi dhe dëmtoi seriozisht magjistralen publike Mitrovicë - Zubin Potok, në zonën që ndodhet midis fshatrave Varage dhe

Zupce, komuna e Zubin Potokut, duke dhënë shenja, sinjale të gabuara, duke vendosur pengesa dhe barrkada në rrugën publike në fjalë, duke rrezikuar në këtë mënyrë trafikun, jetën e njeriut, sigurinë fizike dhe pronat në shkallë të gjerë.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme”, në shkelje të nenit 299 paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

6. I akuzuari M. V., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 6 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. ”D.” V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, shkatërroi, zhvendosi dhe dëmtoi seriozisht magjistralen publike Mitrovicë - Zubin Potok, në zonën që ndodhet midis fshatrave Varage dhe Zupce, komuna e Zubin Potokut, me armë, pengesa dhe barriera të tjera, cka shkaktoi vdekjen e **E. Z.** dhe dëme të konsiderueshme materiale të magjistrales publike dhe automjeteve të _____, duke shkaktuar rrezik të madh për _____ të pranishëm në autokolonën e automjeteve në *locus in quo*.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm”, në shkelje të nenit 291 paragrafët 1, 3 dhe 5 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

7. I akuzuari M. V., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 7 është gjetur JO FAJTOR.

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. ”D.” V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, shkatërroi, zhvendosi dhe dëmtoi seriozisht magjistralen publike Mitrovicë - Zubin Potok, në zonën që ndodhet midis fshatrave Varage dhe Zupce, komuna e Zubin Potokut, me armë, pengesa dhe barriera të tjera, cka shkaktoi vdekjen e **E. Z.** dhe dëme të konsiderueshme materiale të magjistrales publike dhe

automjeteve të _____, duke shkaktuar rrezik të madh për _____ të pranishëm në autokolonën e automjeteve në *locus in quo*.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “pjesëmarrjes në grup që kryen veprë penale”, në shkelje të nenit 320 paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, pari materia me nenin 412 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 1 është gjetur JO FAJTOR

Sepse u vërtetua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Më 26 korrik 2011, rreth orës 13:30, më shumë se pesëdhjetë (50) _____ së Kosovës _____, pjesëtarë të _____, të cilët ishin në gatishmëri në bazën e _____ në Mitrovicë, e ndodhur në _____, morën urdhër të niseshin në drejtim të Portës 31, me qëllim që të merrnin kontrollin e pikës kufitare. Autokolona e automjeteve të _____, pra, u largua nga baza e _____: karvani përbëhej nga dy automjete të blinduara (njëri prej tyre kryesonte autokolonën dhe i dyti ishte në fund të autokolonës) dhe rreth 10-12 automjete të _____ ishin në mes të makinave të blinduara. Ndërsa lëvizte në drejtim të Portës 31 përgjatë rrugës kryesore të asfaltuar mes Mitrovicës dhe Zubin Potokut, në afërsi të fshatit Qabër, autokolona e _____ hasi barrikadën e parë të përbërë nga gurë dhe rërë, e cila pengoi autokolonën të vazhdonte më tej përgjatë rrugës kryesore. Prandaj, autokolona e _____ përdori një rrugë alternative/dytësore, me qëllim që të tejkalonte barrikadën, dhe pastaj u kthye në rrugën kryesore në drejtim të Portës 31.

2. Pasi vazhdoi rrugën për rreth 10 minuta, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupce, autokolona e _____ hasi një pengesë të dytë: këtë herë një barrikadë të përbërë nga tre (3) automjete të vendosura në mes të rrugës. Pasagjerët dhe shoferët e tri automjeteve dolën nga makinat e tyre dhe filluan të përballen me _____, duke bërë gjeste dhe duke bërë gjeste në drejtim të tyre.

3. Rreth tetë (8) persona dolën nga automjetet, dhe nisën të fjalosen me _____. Pak më vonë u afrua edhe një automjet me dy (2) persona dhe u ndal në një distance të caktuar nga barrikada. Disa _____ dolën nga automjetet e tyre dhe i urdhëruan (në gjuhën serbe dhe shqipe) personat të cilët po bllokounin dhe pengonin magjistralen publike që të hiqnin pengesat dhe të largonin makinat e tyre. Këta persona nuk iu bindën atij urdhri dhe vazhduan t'u ulërinin dhe bërtisnin _____, duke bërë gjeste dhe duke iu ngritur gishtat oficerëve të _____. Në këtë moment lideri i operacioneve të _____ dha urdhër që mjeti i blinduar të vazhdonte dhe të largonte automjetet e barrikadës. Sapo automjeti i blinduar iu afrua automjeteve që kishin bllokuar rrugën, rreth tetë (8) personat të cilët po qëndronin prapa barrikadës u larguan dhe u futën në pyllin e ndodhur në anën e majtë. Sapo këta persona u larguan nga barrikada, u dëgjua një e shtëne e parë e vetme zjarri dhe _____ të përfshirë në këtë operacion u informuan menjëherë se njëri prej tyre ishte plagosur

rëndë. Menjëherë pas kësaj pasuan të shtëna të njëpasnjëshme nga ana e majtë, përballë e autokolonës së _____.

4. Një plumb goditi fytyrën e viktimës dhe palës së dëmtuar, E. Z., pjesëtar i _____ i cili po ngiste veturën e dytë të autokolonës së _____. Në momentin që u godit, automjeti i tij ishte i pozicionuar paralel me mjetin e blinduar që kryesonte autokolonën.

5. Pas të shtënës së parë që kishte goditur E. Z., kundër automjeteve të _____ filluan të shtëna të njëpasnjëshme nga tre drejtime të ndryshme dhe kjo zgjati për një periudhë të pacaktuar kohe, jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) minuta. _____ iu kundërpërgjigjën me të shtëna, me qëllim që të mbronin veten e tyre dhe për të marrë trupin e _____, që u zhvendos në mjetin e blinduar. Të shtënat kundër autokolonës së _____ vazhduan deri sa autokolona u tërhoq duke lëvizur në drejtim të Mitrovicës.

6. Incidenti ndodhi në një pasdite vere me diell, kur moti ishte i mirë, me shikueshmëri të mirë.

7. z. F. U. ishte caktuar në automjetin e blinduar që kryesonte autokolonën e _____ drejt Portës 31. Dëshmitari, zoti F. U., ishte brenda automjetit kryesues të blinduar dhe distanca mes tij dhe kryerësve nuk u përcaktua në mënyrë të qartë, por nuk ishte më shumë se 20 metra nga barrikada.

8. Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:25, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupce të komunës së Zubin Potokut, një grup i papërcaktuar njerëzish vepruan duke privuar nga jeta E.Z. për motive raciste dhe kombëtare, për shkak të kombësisë së tij _____ dhe kosovare, në momentin kur E. Z. po zbatonte detyrën e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, ruajtjes së personave apo pronës, dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike, dhe duke vepruar kështu ata rrezikuan me dashje jetën e pasagjerëve në veturë.

9. **R. R.** ishte plotësisht i aftë mendërisht.

Por gjithashtu nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

1. Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D." V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur në privimin nga jeta të E. Z. për motive raciste dhe kombëtare, për shkak të kombësisë së tij _____ dhe kosovare, në kohën kur E. Z. po zbatonte detyrat e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, ruajtjes së personave apo pronës, dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike, dhe duke vepruar kështu ata rrezikuan me dashje jetën e pasagjerëve në veturë.

2. Se numri i automjeteve në barrikadë ose pranë barrikadës ishte më shumë se katër (4).

3. Se numri i personave në barrikadë ishte më shumë se rreth tetë (8).
4. Se i pandehuri dhe i bashkë-pandehuri po bllokonin dhe pengonin magjistralen publike.
5. Se të shtënat zgjatën të paktën 20 minuta.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “vrasjes së rëndë” në shkelje të neneve 146 dhe 147 paragrafët 4, 6, 8 dhe 10 të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 1.5, 1.7, 1.9 dhe 1.10 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

2. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 2 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D." V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur në kryerjen e veprës penale të “Vrasjes së rëndë në tentativë” për të privuar nga jeta udhëtarët e tjerë (_____ B. M. dhe D. P.), në veturë me palën e dëmtuar, të ndjerin E. Z., për motive raciste dhe kombëtare, për shkak të kombësisë së tij _____ dhe kosovare, në kohën kur E. Z. po zbatonte detyrat e tij të ligjshme të mbrojtjes së rendit juridik, ruajtjes së personave apo pronës, dhe mbajtjes së rendit dhe qetësisë publike, dhe duke vepruar kështu, ata rrezikuan me dashje jetën e _____ B. M., D. P. dhe _____ të tjerë të _____ në autokolonën e automjeteve në *locus in quo*.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “vrasjes së rëndë në tentativë”, në shkelje të neneve 146 dhe 147 paragrafët 4, 6, 8 dhe 10 të KPK-së, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 1.5, 1.7, 1.9 dhe 1.10 të KPRK-së, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së.

3. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 3 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D." V.**,

në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur në kryerjen e veprës penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, kishte nën kontroll dhe posedonte një armë të përdorur në vrasjen e rëndë të E. Z., në kundërshtim me ligjin në fuqi lidhur me këto lloj armësh.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve”, në shkelje të nenit 328 paragrafi 1 dhe 2 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 374 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

4. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 3 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D." V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, përdorën forcë dhe kërcënime serioze për të penguar _____ në *locus in quo* në kryerjen e detyrave të ligjshme zyrtare të tyre.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”, në shkelje të nenit 316 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 409 (1) dhe (2) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

5. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 5 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. "D." V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, shkatërroi, zhvendosi dhe dëmtoi seriozisht magjistralen publike Mitrovicë - Zubin Potok, në zonën e ndodhur midis fshatrave Varage dhe Zupçe, komuna e Zubin Potokut, duke dhënë shenja, sinjale të gabuara, duke vendosur pengesa dhe barrikada në rrugën publike në fjalë, duke rrezikuar në këtë mënyrë trafikun, jetën e njeriut, sigurinë fizike dhe pronat në shkallë të gjerë.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme”, në shkelje të nenit 299 paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, pari materia me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

6. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 6 është gjetur JO FAJTOR

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. “D.” V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, shkatërroi, zhvendosi dhe dëmtoi seriozisht magjistralen publike Mitrovicë - Zubin Potok, në zonën e ndodhur midis fshatrave Varage dhe Zupce, komuna e Zubin Potokut, me armë, pengesa dhe barriera të tjera, çka shkaktoi vdekjen e **E. Z.** dhe dëme të konsiderueshme materiale të magjistrales publike dhe automjeteve të _____, duke shkaktuar rrezik të madh për _____ të pranishëm në autokolonën e automjeteve në *locus in quo*.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm”, në shkelje të nenit 291 paragrafët 1, 3 dhe 5 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, pari materia me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

7. I akuzuari R. R., me shënimet personale si më lart, nën Akuzën 7 është gjetur JO FAJTOR.

Sepse nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se:

Më 26 korrik 2011, mes orës 13:30 dhe orës 14:15, në zonën e ndodhur midis fshatit Varage dhe fshatit Zupçe në komunën e Zubin Potokut, të pandehurit **R. R.** dhe **M. “D.” V.**, në bashkëkryerje me të tjerë, duke vepruar bashkërisht dhe duke marrë pjesë së bashku, duke kontribuar ndjeshëm përmes sjelljes dhe veprimeve të paligjshme dhe me dashje të tij, duke qenë pjesë e grupit të personave të përmendur, shkatërroi, zhvendosi dhe dëmtoi seriozisht magjistralen publike Mitrovicë - Zubin Potok, në zonën e ndodhur midis fshatrave Varage dhe Zupce, komuna e Zubin Potokut, me armë, pengesa dhe barriera të tjera, çka shkaktoi vdekjen e **E. Z.** dhe dëme të konsiderueshme materiale të magjistrales publike dhe automjeteve të _____, duke shkaktuar rrezik të madh për _____ të pranishëm në autokolonën e automjeteve në *locus in quo*.

Prandaj LIROHET NGA AKUZA se ka kryer veprën penale të “pjesëmarrjes në një grup që kryen vepër penale”, në shkelje të nenit 320 paragrafi 1 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, pari materia me nenin 412 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

ARSYETIM

I. PROCEDURA, KOMPETENCA E GJYKATËS, PROVAT

1.1. Historia Procedurale

1. Më 08 Maj 2014 Prokuroria e Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë ka ngritur Aktakuzën PP.nr. 103/2011 të datës 7 maj 2014 kundër të akuzuarit **R. R.** dhe **M. V.**, duke i akuzuar ata të dy me veprat penale të "vrasjes së rëndë" në kundërshtim me nenet 146 dhe 147 paragrafët (4), (6), (8) dhe (10) të KPK në lidhje me nenin 23 të KPK-së, "Tentim Vrasje e rëndë" në kundërshtim me nenet 146 dhe 147 paragrafët (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, "mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose përdorim i armëve 'në kundërshtim me nenin 328 paragrafët (1) dhe (2) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së,' pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare "në kundërshtim me nenin 316 (1) dhe (3) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së," Rrezikimi i trafikut publik me veprime apo mjete të rrezikshme' në kundërshtim me nenin 299 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së, "Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" në kundërshtim me Nenin 291 (1), (3) dhe (5) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe "Pjesëmarrja në një grup që kryen vepër penale" në kundërshtim me Nenin 320 (1) të KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së
2. Më 30maj 2014, është mbajtur seanca fillestare për aktakuzën sipas nenit 245 të KPP, në të cilën të akuzuarit **R. R.** dhe **M. V.** janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.
3. Në bazë të nenit 245 (5) të KPP, parashihet edhe një seancë tjetër që quhet seanca e dytë dëgjimore por nuk është e detyrueshme dhe mund të zëvendësohet me kërkesë palëve për të paraqitur vetëm kërkesa me shkrim. Prandaj, të pandehurve u janë dhënë pesëmbëdhjetë (15) ditë afat për të paraqitur ndonjë kundërshtim ndaj provave të evidentuara në Aktakuzë dhe për të paraqitur ndonjë kërkesë për hedhjen e aktakuzës si e ndaluar juridikisht dhe ndonjë kërkesë për hedhjen e aktakuzës për dështimin për të përshkruar veprën penale sipas ligjit.

4. Më 09 Qershor 2014, mbrojtja e **M. V.** ka paraqitur kundërshtimin për provat në aktakuzën e datës 09 Qershor 2014. Më 12 Qershor 2014, mbrojtja e **R. R.** ka paraqitur kundërshtimin për provat në aktakuzën e datës 12 Qershor 2014. Më 27 Qershor 2014, prokuroria ka paraqitur përgjigjen e tyre ndaj kundërshtimit të mbrojtjes së datës 2014.

5. Më 18 korrik 2014 Gjykata ka lëshuar një vendim lidhur me kundërshtimet e mbrojtjes për provat dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës me të cilin refuzon kundërshtimin e mbrojtjes së **M. V.** për provat dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës si të pabazuar. Në pajtim me nenin 249 paragrafi (3) i KPP, Gjykata ka aprovuar kundërshtimin për pranueshmërinë e provave siç është paraqitur në propozimin e parashtruar nga mbrojtja e **R. R.** në lidhje me deklaratën e **S. V.** të datës 07 qershor 2012. Është urdhëruar që procesverbali i marrjes në pyetje të **S. V.** nga prokuroria i datës 07 qershor 2012 të shpallet si i papranueshëm dhe të mbyllet me vulë e të veçohet nga shkresat e lëndës. Me të njëjtin vendim me të cilin refuzohet kërkesa e Mbrojtjes për hedhjen e aktakuzës, gjykata e ka dërguar lëndën për shqyrtimin gjyqësor.

6. Më 2 korrik 2014, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka lëshuar vendimin nr. 01/95 për miratimin e kërkesës së EULEX-it për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor lidhur me lëndën P.nr. 59/2014 e cila u ishte caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it në periudhën prej datës 15 prill deri 30 maj 2014 në Gjykatën Themelore të Mitrovicës. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe veprimet procedurale të ndërmarra para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr 04 / L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka miratuar kërkesën e EULEX-it dhe ka konfirmuar se lënda P.nr. 59/2014, do t'u mbetet gjyqtarëve të EULEX-it.

7. Me urdhrin për caktimin e seancave ta datës 29 tetor 2014, Kryetari i Trupit Gjyqësor ka caktuar shqyrtimin gjyqësor në këtë lëndë për tu mbajtur më 09, 10, 15, 18, 22, 23 dhe 24 dhjetor 2014.

8. Më 29 tetor 2014, Kryetari i Trupit Gjyqësor ka lëshuar një thirrje për të korigjuar ose plotësuar një parashtrësë në pajtim me nenin 442 paragrafi (4) të KPP me të cilën thërret Prokurorinë të plotësojë aktakuzën e tyre, brenda dhjetë (10) ditësh, përkatësisht në pjesën: 1. Sa vepra 'Tentim vrasje e rëndë' pretendohet se janë kryer në këtë rast; 2. Identitetet e palëve të dëmtuara në lidhje me veprën penale të veprës "Tentim Vrasje e rëndë" me që Aktakuza përmend "_____ në konvoj" të cilët nuk kanë qenë të identifikuar; 3. Emri ose emri mbrojtës i "dëshmitarit kryesor 'siç përshkruhet shumë herë në Aktakuzë; 4. Identifikimi i armës (lloji dhe kalibri) që është objekt i veprës penale " mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të armëve ". Asnjë korigjim nuk është paraqitur nga Prokuroria.

9. Më 20 nëntor 2014, Kryetari i Trupit Gjyqësor ka lëshuar një urdhër të ri për caktimin e seancave që shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë të mbahet më 15 dhjetor 2014 dhe 19, 20, 29 dhe 30 janar 2015.
10. Më 15 dhjetor 2014, është hapur shqyrtimi gjyqësor në lëndën P.nr. 59/2014 por pastaj është shtyrë për 19 janar 2015 pasi që, më 12 dhjetor 2014, Prokuroria ka ngritur një Aktakuzë PP.nr. 103/2011 me të cilën akuzohen të pandehurit **R. K.** dhe **S. S.** për veprat penale të lartcekura si dhe ka parashtruar një propozim për bashkimin e procedurave ku kërkohet që procedurat ndaj të pandehurve **R. K.** dhe **S. S.** të akuzuar më 12 dhjetor 2014 të bashkohen me lëndën P.nr. 59/2014.
11. Më 19 Janar 2015, Trupi Gjyqësor ka hapur shqyrtimin gjyqësor në lëndën P.nr. 59/2014 dhe të njëjtën ditë ka lëshuar një Aktvendim Gojor me të cilin refuzon propozimin e prokurorisë për bashkimin e procedurave të datës 12 Dhjetor 2014 në bazë të së dretës së të pandehurve për gjykim të drejtë dhe të shpejtë siç parashihet me Nenin 5 Para. (1) i KPP dhe në bazë të faktit që hetimi në lëndën Ppr. 103/2011 vazhdon akoma kundër të pandehurve tjerë dhe propozimet tjera të mundshme për bashkimin e procedurave mund ta vonojmë edhe më shumë fillimin e shqyrtimit gjyqësor në lëndën P.nr. 59/2014.
12. Seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur të hapura për publikun më 19, 20 dhe 29 janar 2015, 27 shkurt 2015, 09, 12, 17, 18, 20, 23 mars 2015 dhe 01, 16 dhe 17 prill 2015.
13. Seancat e shqyrtimit gjyqësor të datës 29 Janar 2015 nga ora 15:27 deri 15:50 dhe të datës 30 Janar 2015 janë mbajtur të mbyllura për publik.
14. Gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ta datës 19 Janar 2015, të pandehurit **R. R.** dhe **M. V.** janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.
15. Të gjitha seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur në prani të: akuzuarit **R. R.**, përfaqësuar nga avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic si avokat kryesor mbrojtës si dhe Nebojsa Vlajic, akuzuarit **M. V.** përfaqësuar nga avokati mbrojtës Agim Lushta, viktimave përfaqësuar nga Burhan Maxhuni, palës së dëmtuara D. Z., zyrtarit D. P. dhe zyrtarit B. M. dhe prokurorit Neeta Amin, prokurorit Pascal Persoons, prokurores Lili Oprea dhe prokurorit Tomas Skala.
16. Më 01 Prill 2015, është bërë një vizitë në vendngjarje ku pretendohet se janë kryer veprat penale dhe në depon që gjendet në fshatin Zupce, Zubin Potok.
17. Më 16 Prill 2015, Trupi Gjyqësor ka dëgjuar fjalët përfundimtare të prokurorisë, përfaqësuesit të viktimave dhe mbrojtjes.

18. Dispozitivi i Aktgjykimit është shpallur më 20 prill 2015.
19. Në përputhje me nenin 215 nënpara. (1.1) KPP, përkthyesit kanë bërë përkthimin simultan përgjatë tërë procedurës gjyqësore dhe të gjitha dokumentet relevante për shqyrtimin gjyqësor janë përkthyer në gj. serbe, shqipe dhe angleze.
20. Sipas nenit 541 të KPP që ka hyrë në fuqi më 01 Janar 2013¹, Shqyrtimi gjyqësor është bërë sipas dispozitave të Kodit të ri të Procedurës Penale .

1.2. Kompetenca e Gjykatës

21. Sipas nenit 472, para. (1), të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës ("KPP"), Trupi Gjykses debatoi nëse Gjykata ka kompetencë dhe nëse ishte e nevojshme të plotësohej procedura. Anëtarët e trupit gjykses unanimisht kanë votuar se kjo Gjykatë ka kompetencë dhe se nuk ka nevojë për ndonjë procedurë tjetër.
22. Më 04 gusht 2011, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka caktuar gjyqtarin e procedurës paraprake të EULEX-it nga Gjykata Themelore e Mitrovicës për procedurën e lëndës së Policisë nr. 2011-BH-091 kundër të pandehurve të panjohur nën hetime për veprat penale që janë objekt të këtij shqyrtimi gjyqësor, në pajtim me nenin 3.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).
23. Më 08 maj 2014, Prokuroria ka ngritur Aktakuzën PP.nr. 103/2011 të datës 07 maj 2014, me të cilën akuzohen të pandehurit **R. R.** dhe **M. V.** për veprat penale që janë objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor.
24. Më 02 korrik 2014, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 4 para. 1, pika 1.1 dhe 1.8 e Ligjit nr. 03/L-223 mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe nenet 45, 46 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtaritë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në përputhje me Ligjin nr. 04/L-273 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që lidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropianë për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës, ka lëshuar Vendimin nr. 01/95 me të cilin Këshilli Gjyqësor i Kosovës aprovon që lënda Pnr. 59/2014 të shqyrtohet nga Gjyqtarët e EULEX-it.

¹ PENALE Nr. 04/L-123 KODI I PROCEDURËS;

25. Prandaj, Trupi Gjykes i përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it ka kompetencë për lëndën.

26. Gjithashtu, veprat bien në kompetencë lëndore dhe territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës (para datës 01 Janar 2013 të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës) siç parashihet me nenin 29 të KPP.

- vii. Dëshmitari Sh. S. (i cili ishte në veturë të parë të konvojit): *"Aty kishte rreth 5, 6 apo deri në 10 persona"*¹⁸.
- viii. Dëshmitari B. M.: *"Po, aty kishte 3 apo 4 persona duke qëndruar pas automjeteve të tyre"*¹⁹.
- ix. Dëshmitari M. Sh.: *"Jo. Vetëm këta katër persona"*²⁰.
- x. Dëshmitari A.I.: *"Pas automjeteve që e bllokoni rrugën kishte 4 deri në 6 persona duke qëndruar atje"*²¹.
- xi. Dëshmitari H. H.: *"I kam vërejtur 4 persona të cilët dolën nga tre veturat dhe përdoren veturat e tyre për të bllokuar rrugën"*²².
- xii. Dëshmitari K. H.: *"Kishte katër persona. Unë isha në veturën e katërt apo të pestë"*²³.
- xiii. Dëshmitari E. D.: *"Kryetar i Trupit Gjykes: Ju sapo e patë një person në atë barrikadë? Erduan Dabi: kjo është përafërsisht kujtimi"*²⁴.
- xiv. Dëshmitari G. D.: *"ne i pamë 4 – 5 persona dhe 3 – 4 automjete"*²⁵.
- xv. Dëshmitari V. R.: *"Pasi që automjeti ynë ishte pak larg nga ajo barrikadë, dukej që aty kishte 2 – 3 automjete që bllokuan rrugën. Aty kishte 3 – 4 persona gjithashtu"*²⁶.
- xvi. Dëshmitari F. U.: *"Dhjetë deri në pesëmbëdhjetë persona, pesë vozitës plus persona të tjerë"*²⁷.

¹² Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 25, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 38, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 30 janar 2015, faqe 14, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 13, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹⁶ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 23, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹⁷ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 31, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 39, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

¹⁹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 45, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

²⁰ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 18, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 4, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²² Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 33, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 8, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 18 mars 2015, faqet 60-61, Tab 4, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 18, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²⁶ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 21, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

²⁷ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 20 janar 2015, faqe 19, Tab 23, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI II;

- xvii. Dëshmitari I. A.: *"Kryetar i Trupit Gjykses: A jeni të sigurt që personat të cilët ishin në barrikadë para të shtënave ishin vetëm 8 person, sipas juve? I. A.: Jo. Nuk mundem të them këtë që ishin saktë 8 persona sepse ishte një terren malor dhe kishte lëvizje të njerëzve"*²⁸.

B.2. Numri i automjeteve të pranishme në barrikadë

55. Trupi gjykses mori disa përshkrime të barrikadës së dytë, do të thotë atë ndërmjet dy (2) dhe pesë (5) automjete ishin të pranishme në barrikadë:
- i. Dëshmitari F.A.: *"Aq sa munda të vërej, mund t'i shihja tre vetura. Ndoshta atje kishte katër por unë mund të shihja vetëm tre sepse automjeti i blinduar ishte përballë meje"*²⁹.
 - ii. Dëshmitari M. Sh.: *"Aty u paraqiten tre automjete"*³⁰.
 - iii. Dëshmitari A. R.: *"Përafërsisht 3 – 4 nëse më kujtohet saktë"*³¹.
 - iv. Dëshmitari V. K.: *"Unë e kam vërejtur që aty kishte 2 – 3 automjete në rrugë"*³².
 - v. Dëshmitari F. Z.: *"Unë i pashë 2, 3 apo 4 automjete më së shumti sepse një situatë tjetër ndodhi atje dhe njeriu nuk mund të koncentrohej"*³³.
 - vi. Dëshmitari F. Sh.: *"Më sa më kujtohet mua, dhe më sa kam parë, atje kishte 4 – 5 automjete"*³⁴.
 - vii. Dëshmitari Sh. S.: *"Atje kishte 3 apo 4 automjete që e përbënin barrikadën e dytë"*³⁵.
 - viii. Dëshmitari H. H.: *"Unë i kam vërejtur 4 persona që kanë dalur nga tre veturat dhe përdoren veturat e tyre për të bllokuar rrugën"*³⁶.
 - ix. Dëshmitari I. L.: *"Unë mendoj që aty kishte një veturë opel, Renault, Golf 3, VW"*³⁷.
 - x. Dëshmitari K. K.: *"Pastaj ne e hasëm një barrikadë prej tre deri në katër automjete"*³⁸.
 - xi. Dëshmitari E. D.: *"Nuk më kujtohet se sa vetura saktë erdhën por aty kishte tre apo katër"*³⁹.
 - xii. Dëshmitari A. I.: *"Më sa më kujtohet, atje kishte katër automjete civile"*⁴⁰.
 - xiii. Dëshmitari G. D.: *"Në automjet ku unë isha, ne mund të shihnim më pak sepse për faktin thjesht që unë isha në automjetin e fundit dhe ai ishte i blinduar [...] ne pamë [...] 3-4 automjete"*⁴¹.
 - xiv. Dëshmitari V. R.: *"Pasi që automjeti ynë ishte pak larg nga ajo barrikadë, dukej që atje kishte 2 – 3 automjete që bllokuan rrugën atje"*⁴².
 - xv. Dëshmitari F. U.: *"Prokurori i EULEX-it: Dëshmia e juaj vazhdoi, ju thatë që ju e keni parë një Opel Corsa të verdhë dhe katër automjete të tjera erdhën dhe e bllokuan rrugën. F. U.: Po [...] Prokurori i*

²⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 21, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

²⁹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 24, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

³⁰ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 18, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

³¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 30 janar 2015, faqe 8, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

³² Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 30, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

³³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 38, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

³⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 30 janar 2015, faqe 14, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

³⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 38, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

³⁶ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 33, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

³⁷ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 24, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

³⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 38, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

³⁹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 18 mars 2015, faqe 60, Tab 4, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁴⁰ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 5, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁴¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 18, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁴² Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 21, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

*EULEX-it: A janë këto katër vetura që ju i keni vizatuar atje, A, B, C, D, E, a janë ato veturat që ju sapo dhatë provat? F. U.: Po*⁴³.

B.3. Në lidhje me distancën ndërmjet automjeteve të Konvojit të _____ dhe Barrikadës

56. Trupi gjykues pranoi disa përshkrime të barrikadës së dytë në lidhje me distancën ndërmjet automjeteve që formonin konvojin e _____ dhe barrikadës, do të thotë distanca ishte ndërmjet shtatë (7) dhe 70 metra:

- i. Dëshmitari F. Z.: *"Unë mund të them që distanca ishte përafërisht 50 metra"*⁴⁴.
- ii. Dëshmitari V. K.: *"Ka mundur të jetë 25 – 30 metra. Nuk jam 100 % i sigurt sepse unë nuk shkova në ndonjë pikë deri te barrikada me qëllim për të ditur se cila ishte distanca"*⁴⁵.
- iii. Dëshmitari A. R.: *"është e mundshme që distanca ka mundur të jetë 50 – 70 metra edhe pse unë nuk mundem të them këtë saktë"*⁴⁶.
- iv. Dëshmitari F. Sh.i: *"Ishte pak a shumë 100 metra distanca, ishte një konvoj i gjatë i automjeteve të policisë dhe ne ishim në fund të konvojit"*⁴⁷.
- v. Dëshmitari F. F.: *"ne jemi duke biseduar rreth skenës 215 metra gjatë"*⁴⁸.
- vi. Witness N. S.: *"Around 20, 30 to 40 meters but I don't know exactly"*⁴⁹.
- vii. Dëshmitari M. Sh.: *"Përafërisht 7 apo 8 metra"*⁵⁰.
- viii. Dëshmitari A. I.: *"Kur unë dola nga vetura për të shkuar tek automjeti i blinduar me qëllim të informimit të kolegëve të mi për të dëgjuar radion, distanca ishte 20 deri në 30 metra"*⁵¹.
- ix. Dëshmitari H. H.: *"15 deri në 20 metra"*⁵².
- x. Dëshmitari Sh. S.: *"Distanca ishte mjaft e madhe por unë nuk mund të shihja ndonjë person duke bartur armë"*⁵³.
- xi. Dëshmitari K. K.: *"Nuk mundem të deklaroj atë me saktësi"*⁵⁴.
- xii. Dëshmitari E. D.: *"Kjo varet në shpejtësinë që vetura mund të zhvillonte për të arritur ato automjete, por kjo nuk ka mundur të jetë më tepër se njëzet deri në tridhjetë metra"*⁵⁵.

B.4. Në lidhje me kushtet e dukshmërisë së automjetit të dëshmitarit F. U.

57. Trupi gjykues pranoi disa përshkrime të barrikadës së dytë në lidhje me kushtin e dukshmërisë së _____ F. U.:

⁴³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 20 janar 2015, faqet 6-7, Tab 23, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI II;

⁴⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 38, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁴⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 29 janar 2015, faqe 31, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁴⁶ Shqyrtimi kryesor, 30 janar 2015, faqe 7, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁴⁷ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 30 janar 2015, faqe 14, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁴⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 6, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III; Shih gjithashtu Raportin mbi Ekzaminimin e Skenës së krimin, faqe 153, Dosja e prokurorisë I;

⁴⁹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 33, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁵⁰ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 18, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁵¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 17 mars 2015, faqe 5, Tab 2, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁵² Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 34, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁵³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 39, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁵⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 mars 2015, faqe 38, Tab 1, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁵⁵ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 18 mars 2015, faqe 63, Tab 4, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

- i. Dëshmitari E. D.: *"Në distancë prej tridhjetë metrave, në atë dendësi të shumë të xhamit ju nuk mund të shihni atë"*⁵⁶.
- ii. Dëshmitari I. S.: *"Xhami i përparmë i automjetit është mjaft i madh kështu që njeriu mund të ketë dukshmëri të madhe për të parë personat"*⁵⁷.
- iii. Dëshmitari E. D.: *"Kjo varet se kush ishte duke vozitur atë automjet të blinduar, në tërësi varet prej lartësisë së personit, nëse personi është pak si goxha i gjatë sikurse unë, ju mund të keni dukshmëri të mirë, por nëse njeriu është i shkurtër atëherë i zvogëlohet dukshmëria. Përndryshe, xhami i përparmë është i dukshëm; dhe nëse vozitësi do të ishte person i shkurtër do të kishte dukje më të mëtejme dhe jo afër më poshtë pamjen. Kryetari i Trupit Gjykes: Por udhëtarët që janë në anën e pasme, kanë shikim më të mirë se vozitësi? E. D.: Mund të jetë kështu, sepse ata qëndrojnë më lart sesa vozitësi, pasi që vozitësi është i pozicionuar më ulët"*⁵⁸.

B.5. Lidhur me kohën e të shtënave

58. Trupi gjykues mori disa përrshkrime të barrikadës së dytë, në veçanti se sa kanë zgjatur të shtënat:

- i. Dëshmitari I. S.: *"Kjo ishte shumë shkurt. Nuk mundem të specifikoj në kohë se sa gjatë ka zgjatur por ishte shumë shkurt dhe një ngjarje shumë e shpejtë dhe unë nuk mundem të përshkruaj kohën"*⁵⁹.
- ii. Dëshmitari B. M.: *"Unë mendoj që ishte rreth 20 minuta"*⁶⁰.
- iii. Dëshmitari Sh. S.: *"Përafërsisht, më as më kujtohet mua, rreth 10 minutave"*⁶¹.
 - iv. Dëshmitari I. L.: *"15 deri në 20 minuta e shumta"*⁶².
 - v. Dëshmitari G.D.: *"Rreth 15 minuta"*⁶³.

59. Nga të gjitha këto versione të ndryshme, Gjykata besoi versionin e deklaruar nga _____ i autokolonës, Dëshmitari I. A.⁶⁴. Së pari, në një moment të caktuar, ai ishte duke qëndruar jashtë automjetit të tij, me dukshmëri të mirë, pa asnjë kufizim nga mburojat, dritaret apo pozicionet e automjeteve të tjera, që formonin autokolonën e _____. Së dyti, ai dha deklaratë të drejtpërdrejtë dhe të ndershme, gjithmonë duke iu referuar faktit se ky ishte perceptimi i tij (për krahasim, Trupi Gjykues vuri re vështirësinë që pati Dëshmitari F. U. në dhënien e distancës së përafërt). Së treti, I. A. vizatoi skicën më

⁵⁶ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 18 mars 2015, faqe 63, Tab 4, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI IV;

⁵⁷ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 09 mars 2015, faqe 17, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁵⁸ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 18 mars 2015, faqe 59, Tab 4, Court Binder TRIAL, VOLUME IV;

⁵⁹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 mars 2015, faqe 14, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁶⁰ Procesverbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 9 mars 2015, faqe 46, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁶¹ Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 9 mars 2015, faqe 40, Tab 12, Dosja e Gjykatës PROCESI GJYQESOR, VELLIMI III;

⁶² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 09 mars 2015, faqe 26, Tab 12, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VELLIMI III;

⁶³ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 17 mars 2015, faqe 19, Tab 2, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VELLIMI IV;

⁶⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqet 4-22, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VELLIMI III;

të saktë të incidentit dhe sidomos të pozicionit të veturave që formimin barrikadën menjëherë pas ngjarjes⁶⁵. Së katërti, atë ditë I. A. ishte _____, pra me më shumë përgjegjësi për të parë ngjarjet dhe për të marrë një pozicion konkret përmes ndonjë urdhri për veprim. Së fundi, versioni i tij i ngjarjeve u konfirmua nga provat materiale të mbledhura (p.sh. fotot e veturave që tregojnë se në barrikadë ndodheshin vetëm tre vetura⁶⁶, dhe radio-komunikimet që zbuluan se të shtënat zgjatën të paktën nëntë minuta nga komunikimi i parë deri në komunikimin që raportoi lëndimin e E. Z.⁶⁷).

B.6. Për sa i përket lidhjes ndërmjet personave të cilët shtinë me armë dhe personave të pranishëm në barrikadë

60. Për sa i takon lidhjes midis organizimit të barrikadave dhe të shtënave, dhe në bazë të dëshmive, Gjykata arriti në përfundimin se e vetmja provë e disponueshme në lidhje me këtë është gjesti (ngriti dorën e tij) që u bë nga një person i pranishëm në barrikadë, i cili ishte duke mbajtur një telefon, ku u përcaktua në mënyrë unanime nga dëshmitarët të cilët e panë, që ai person i veçantë nuk ishte njëri nga të pandehurit⁶⁸.

61. Prandaj, nuk mund të thuhet se personat që ishin në barrikadë kishin dijeni për planin për të shtënë mbi autokolonën e _____. E vetmja gjë që mund ta bëjë Trupin Gjyqësor të vendosë se ekziston një lidhje është fakti që personat të cilët ishin në barrikadë u larguan nga barrikada pak para të fillonin të shtënat.

62. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, kryetari i trupit gjyqësor e pyeti Dëshmitarin I. A.:

“Kryetari i trupit gjyqësor: A mund të na shpjegoni, ju lutem, kohën midis momentit kur njerëzit u tërhoqën nga barrikada dhe të shtënës së parë që u shkrep, a vutë re ndonjë gjest apo dëgjuaat ndonjë të thirrur nga njerëzit në barrikadë për ata që shtinë?”

I. A.: Ndërkohë që personat pas barrikadës u tërhoqën dhe ndërkohë që ata po hynin në pyllin aty pranë, në pozicionin e dytë, ku i përshkrova ata persona, fytyrat e të cilëve mund vetëm t'i shihja, pashë një dorë të ngrihet lart.

Kryetari i trupit gjyqësor: A jeni i sigurt?

I.A.: Po.”⁶⁹

63. Kjo deklaratë është e besueshme për shkak se u dha nga një dëshmitar i cili kishte shikueshmërinë më të mirë në autokolonën e _____ dhe deklarata e tij vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë⁷⁰.

⁶⁵ Shih Dëshminë e dëshmitarit I. A., 02 gusht 2011, faqe 2780, Dosja e Prokurorisë VII;

⁶⁶ Shih foto-albumin me foto nga videot e postuara në vesite publike, faqet 1158 to 1185, Dosja e Prokurorisë IV;

⁶⁷ Shih Raport Përmbledhës i Ngjarjeve, datat 25/26/27-07-2011, faqe 171, Dosja e Prokurorisë I;

⁶⁸ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqet 21, 26, 38, 40, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 09 mars 2015, faqet 12, 25, 28, Tab 12, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 12 mars 2015, faqet 8-9, 12-13, 15, 19, 20, 21, 34, 39, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqet 63, 66, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁶⁹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqe 21, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

⁷⁰ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqet 21, 26, 38, 40, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 09 mars 2015, faqet 12, 25, 28, Tab 12, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 12 mars 2015, faqet 8-9, 12-13,

64. Megjithatë, nuk ka asnjë provë që do të mund të vërtetonte se personat e pranishëm në barrikadë dinin për planit e hapjes zjarr në drejtim të _____. Personi i cili e bëri këtë gjest që njerëzit të largoheshin nga barrikada, duhet të dinte me siguri në lidhje me planin për të shtënë mbi ta. Është gjithashtu e mundshme që personat duhej të largoheshin, sepse do të ndodhnin të shtënat. Por nuk është plotësisht i sigurt se të gjithë njerëzit në barrikadë e dinin se disa persona do të hapnin zjarr. Një tjetër shpjegim i arsyeshëm është se njerëzit në barrikadë mund të kenë qenë atje vetëm për të formuar barrikadën në rrugë dhe për të protestuar kundër kalimit të _____ së Kosovës. Për të krijuar lidhjen midis personave në barrikadë dhe të shtënave, Gjykatës do t'i nevojiten prova, për shembull, të regjistrimeve dhe përgjimeve telefonike apo prova që vërtetojnë ekzistencën e disa takimeve të zhvilluara më parë para ngritjes së barrikadës, që mund të demonstrojnë këtë lidhje. Dëshmitari B nuk mundi t'ia japë Gjykatës të gjitha këto prova.⁷¹

C. Lidhur me akuzat faktike ndaj të pandehurit M. V.

65. Provat materiale të paraqitura kryesisht nuk lidhen me të pandehurin M. V.. E vetmja provë materiale e paraqitur ka të bëjë me objektet e sekuestruara (dokumente propagandistike serbe dhe disa raporte), që nuk mund të tregojnë se i pandehuri ishte në barrikadë apo edhe në Mitrovicën e Veriut në kohën e ngjarjeve.

66. Lidhur me identifikimin e të pandehurit M.V., vetëm një dëshmitar, përkatësisht F. U., mundi ta identifikojë atë në barrikadën e dytë.

67. Dëshmitari I. A. deklaroi: *"Personi në rrugë kishte këmishë të zezë me mëngë të shkurtra. Dikush nga grupi që ishte më larg, kishte veshur diçka të bardhë"*.⁷² Përveç kësaj, Dëshmitari E. D. deklaroi: *"Unë mund të kujtoj vetëm tiparet e një personi në barrikadë. Ai kishte veshur këmishë të zezë me flokë të shkurtër të zinj [...] Dua të theksoj se mund të përqendrohesh vetëm tek një person, sepse u shpërqendrova nga të gjitha urdhrat e komandantit"*.⁷³

68. Kur iu kërkua ta identifikonin atë person në foto-albumin që iu tregua gjatë intervistave⁷⁴, dëshmitari I. A. njohu personin me nr. 2 në foto-albumin nr. 1⁷⁵. Dëshmitari E. D. njohu personin me nr. 6 në foto-albumin nr. 2⁷⁶. Dy dëshmitarët nuk e njohën të

15, 19, 20, 21, 34, 39, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqet 63, 66, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁷¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 27 shkurt 2015, faqe 11, Tab 9, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

⁷² Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, I. A., 05 gusht 2011, faqe 2785, Dosja e Prokurorisë VII;

⁷³ Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, E. D., 17 gusht 2011, faqe 2677, Dosja e Prokurorisë VI;

⁷⁴ Shih foto-albumin, faqet 2794-2799, Dosja e Prokurorisë VII; Shih foto-albumin, faqet 2680-2687, Dosja e Prokurorisë VI;

⁷⁵ Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, I. A., 05 gusht 2011, faqe 2785, Dosja e Prokurorisë VII;

⁷⁶ Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, E. D., 17 gusht 2011, faqe 2678, Dosja e Prokurorisë VI;

pandehurin **M. V.**, fotografia e të cilit ishte gjithashtu në foto-albume. Në vend të tij, ata të njohën një person tjetër.

69. Prandaj Gjykata duhet të arrijë në përfundimin se asnjëri prej dëshmitarëve të tjerë të cilët dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, nuk e identifikuan të akuzuarin **M. V.** si të pranishëm në barrikadë. Përveç kësaj, dëshmitari B nuk e pa të akuzuarin **M. V.** në afërsi të zonës së incidentit më 26 korrik 2011 dhe, për më tepër, dëshmitari B nuk e njohu atë në lidhje me ndonjë veprim të mëtejshëm që ka ndodhur në atë zonë.

70. Si rezultat, vetëm një dëshmitar e identifikoi të akuzuarin **M. V.** si të pranishëm në barrikadë.

71. Gjatë deklaratës së tij në shqyrtimin paraprak, dëshmitari F. U. deklaroi se ishte i sigurt se njeriu i paraqitur në fotografinë nr. 1 të foto-albumit nr. 4 është njëri nga personat që ai kujton në barrikadë sepse *“ai ishte veçanërisht aktiv në bërkitje dhe bërjen e gjesteve kundër nesh”*.⁷⁷ Më tej, në lidhje me dy individët që njohu në foto-albume, përfshirë të akuzuarin **M. V.**, ai deklaroi se *“meqë nuk i kisha parë ose takuar më parë ata, unë u përqendrova tek ata, me qëllim që të isha në gjendje t’i identifikoj në të ardhmen”*.⁷⁸

72. Megjithatë, Gjykata vërejti se, gjatë deklaratës së tij të parë të datës 26 korrik 2011, dëshmitari F. U. deklaroi se ai identifikoi katër (4) persona⁷⁹, por ai nuk identifikoi personin në fotografinë nr. 1, i cili ishte i pandehuri **M. V.**. Prandaj, dëshmitari F. U. nuk e identifikoi të akuzuarin **M. V.** si të pranishëm në barrikadë, megjithëse fotoja e tij ishte në foto-albume.

73. Përsëri, gjatë intervistës së tij të dytë në procedurën paraprake më 29 korrik 2011, dëshmitari F. U. nuk e identifikoi personin në fotografinë nr. 1, i cili ishte i pandehuri **M. V.**

74. Për më tepër, gjatë një interviste tjetër më datë 5 korrik 2012, dëshmitari F. U. deklaroi diçka të ndryshme nga më parë, konkretisht, *“isha më i përqendruar tek njerëzit që i njihja që më përpara”*.⁸⁰

75. Kështu, duket se ekziston dyshimi i arsyeshëm se pse ky dëshmitar kyç përmend vetëm të pandehurin **M. V.** gjatë intervistës së tij të tretë, kur ai shpjegoi se ishte i përqendruar tek ai, ndër të tjera, pikërisht *“me qëllim që të isha në gjendje t’i identifikoj ata në të ardhmen”*.⁸¹

76. Sigurisht, gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitari F. U. e identifikoi të akuzuarin **M. V.** si personi i cili ishte i pranishëm në barrikadë në kohën e pritës.⁸² Megjithatë, ky identifikim u

⁷⁷ Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, F. U., 05 gusht 2011, faqe 1841, Dosja e Prokurorisë V;

⁷⁸ Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V;

⁷⁹ Deklaratë e dëshmitarit, F. U., 26 korrik 2011, faqe 1813, Dosja e Prokurorisë V;

⁸⁰ Proces-verbal i Dëgjimit të Dëshmitarit në një Hetim, F. U., 05 korrik 2012, faqe 1880, Dosja e Prokurorisë V;

⁸¹ Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V;

⁸² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqet 15-17, 22, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II;

kushtëzua më parë nga vendi ku i pandehuri ishte ulur në sallën e gjyqit, nga publicitetit lidhur me shqyrtimin gjyqësor dhe nga njohja e mëparshme e bërë nga dëshmitari.

77. Për më tepër, Trupi Gjykses gjithashtu gjeti mospërputhje se si dëshmitari F. U. arriti ta identifikojë këtë person të caktuar në fotografinë nr. 1, domethënë, të akuzuarin M. V.. Në një deklaratë, dëshmitari tha se e kishte identifikuar sepse ai ishte aktiv dhe se dëshmitari ishte i fokusuar tek ai, sepse nuk e njihnte. Por në një deklaratë tjetër, dëshmitari F. U. deklaroi se *“aty ishte një person, ndoshta e kam gabim, në deklaratat e mia e kam përmendur, isha më i fokusuar tek njerëzit që i njihja që më parë”*.⁸³

78. Krahas kësaj, Gjykata vërejti një numër problemesh dhe mospërputhjes të tjera që ngrenë dyshime në lidhje me identifikimin e të akuzuarit M.V., të bërë nga dëshmitari F. U., përkatësisht:

i. Ka mospërputhje mes dëshmisë së dëshmitarit F. U. dhe dëshmive të zyrtarëve të tjerë të policisë lidhur me distancën midis autokolonës së _____ dhe barrikadës. Dëshmitari F. U. tha se ishte 10 metra.⁸⁴ _____ I. A. tha se distanca ishte 15 deri në 40 metra⁸⁵. Po kështu, shoferi i veturës së parë të autokolonës së _____ deklaroi se ishte 20 metra⁸⁶. Këto nuk janë relevante për Gjykatën. Gjykata është e vetëdijshme se është gjithmonë e vështirë të japësh një distancë të saktë dhe të drejtë, sidomos në situata të vështira dhe të rrezikshme, kur njerëzit janë në lëvizje. Përveç kësaj, veturat në barrikadë u zhvendosën dhe u larguan nga autokolona e _____.

79. Megjithatë, Gjykata vërejti se ekzistojnë edhe mospërputhje të tjera:

i. Ka mospërputhje mes dëshmive të dëshmitarit F. U. dhe _____, të cilët dëshmuar në këtë lëndë, në lidhje me numrin e personave të pranishëm në barrikadë, siç theksoi Gjykata më sipër.⁸⁷

ii. Ka mospërputhje mes dëshmive të dëshmitarit F. U. dhe _____ të cilët dëshmuar në këtë lëndë, në lidhje me numrin e automjeteve të pranishme në barrikadë, siç theksoi Gjykata më sipër.⁸⁸

iii. Ka mospërputhje mes dëshmive të dëshmitarit F. U. dhe _____ të cilët dëshmuar në këtë lëndë, lidhur me atë se si ishin vendosur veturat që formonin barrikadat

⁸³ Proces-verbal i Dëgjimit të Dëshmitarit në një Hetim, F. U., 05 korrik 2012, faqe 1880, Dosja e Prokurorisë V;

⁸⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqe 13, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II;

⁸⁵ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqet 8, 12, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

⁸⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqe 63, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁸⁷ Shih pjesën B.1.;

⁸⁸ Shih pjesën B.2.;

(siç mund të shohë Gjykata nga skicat e vizatuara nga dëshmitari I. A. dhe nga dëshmitari F. U.).⁸⁹

iv. Ka mospërputhje mes dëshmive të dëshmitarit F. U. dhe _____ lidhur me xhamin e automjetit të blinduar të _____ dhe, kësisoj, shikueshmërisë. Dëshmitari E. D., i cili ishte shoferi i automjetit të blinduar, automjeti i parë në autokolonën e _____, tha se dritarja e veturës ishte prej xhami të trashë.⁹⁰ Ai tha se kur dritarja është prej qelqi të trashë, nuk mund të shohësh sa duhet. Përveç kësaj, Dëshmitari F. U. tha se automjeti ku ndodhej ai kishte vetëm një dritare.⁹¹ Shoferi i automjetit të parë, Dëshmitari E. D., deklaroi se ishin dy dritare (e mesmja ishte e ndarë me metal në mes).⁹² Prandaj, në qoftë se është kështu, nëse në mes të dritares së veturës ka një shufër, atëherë sheh më pak.

80. Si rezultat, në lidhje me identifikimin e të akuzuarit M. V., Gjykata ka vetëm një dëshmitar që e identifikon atë, domethënë F. U.. Megjithatë, gjatë deklaratës së tij të parë Dëshmitari nuk tha asgjë në lidhje me këtë identifikim, ndërsa gjatë një deklaratë të dhënë më 05 gusht 2011, Dëshmitari theksoi se ai u përqendrua në ata dy persona pikërisht me qëllim që të ishte në gjendje t'i identifikonte ata në të ardhmen.⁹³

81. Përkundrazi, _____, Dëshmitari I. A., i cili doli jashtë automjetit të tij të _____ në ditën e incidentit dhe, për këtë arsye, pati shikueshmëri të plotë, i cili ishte në të njëjtën veturë me dëshmitarin F. U., nuk arriti ta njohë të pandehurin M. V., por vetëm tha se personat që ai të mundi të njohë kishin veshur gjithashtu këmisha të zeza dhe ishin shumë aktivë.⁹⁴

82. Për të gjitha këto arsye, për Gjykatën duket e qartë se çdo vëzhgues objektiv mund të kishte dyshime objektive nëse i pandehuri M. V. ishte në barrikadën e dytë në ditën e incidentit.

D. Lidhur me akuzat faktike ndaj të pandehurit R. R.

⁸⁹ Shih Skicën e vizatuar nga F. U., faqe 1825, Dosja e Prokurorisë V; Shih Skicën e vizatuar nga I. A., faqe 2780, Dosja e Prokurorisë VII;

⁹⁰ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqet 59, 63, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁹¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqe 16, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II;

⁹² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqet 59-60, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁹³ Shih Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V; Për më tepër, z. F. U. deklaroi gjatë Shqyrtimit Gjyqësor se "*Unë e identifikova atë para se ai të bëhej i dyshuar. Unë nuk e identifikova atë me emër por bazuar edhe nga media sepse ata ishin edhe në media. Por unë e identifikova atë pa emër por bazuar nga fotografitë*", Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqe 22, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II;

⁹⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqet 8, 13-14, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

D.1. Versioni i alibisë

83. Gjykata është e sigurt se i pandehuri **R. R.** ishte afër depos së ndodhur afër barrikadës së dytë, pas ose gjatë pjesës së fundit të të shtënave, për shkak të deklaratës së dhënë nga dëshmitari B.⁹⁵ Gjykata e gjeti deklaratën e dëshmitarit B të besueshme dhe koherente. Dëshmitari B nuk ka lidhje me të pandehurit dhe akti i dëshmitarit për të marrë një qëndrim tregon guxim të madh. Prandaj Gjykata gjeti se Dëshmitari B është plotësisht i besueshëm, sipas mendimit të këtij Trupi Gjykues.

84. Megjithatë ky fakt në vetvete nuk është vendimtar. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes, Gjykata e di me siguri se distanca nga pika A (domethënë, barrikada e dytë) në pikën B (depoja) është 674 metra.⁹⁶ Duke përdorur logjikën e shëndoshë, Gjykata di gjithashtu se shpejtësia normale e ecjes në këmbë është 5 kilometra në orë. Pra, Gjykata mund të arrijë në përfundimin se do të duheshin **8 minuta** që i pandehuri, duke ecur me një shpejtësi normale në këmbë, të shkonte nga pika A në pikën B ($5.000 \text{ m/orë} = 83,33 \text{ metra për minutë}$, dhe $674 \text{ metra pjesëtuar me } 83,33 = 8 \text{ minuta}$).

85. Për më tepër, Gjykata gjithashtu duhet të theksojë se i pandehuri është sportist. Kjo u konfirmua nga Dëshmitari S. V..⁹⁷ I pandehuri duket të jetë në gjendje të mirë shëndetësore. Pra, po të ishte e nevojshme, i pandehuri mund të kishte ecur më shpejt apo madje edhe të vraponte gjatë asaj distance.⁹⁸

86. Por më e rëndësishmja është se sipas Dëshmitarit B, pasi u fikën sirenat, Dëshmitari pa afër depos një grup personash (rreth 10 persona) dhe vërejtë civilë të armatosur me armë zjarri⁹⁹. Dëshmitari B gjithashtu deklaroi se ai/ajo vërejtë shpërndarjen e armëve dhe të municioneve në Zubin Potok (të tipit AK-47)¹⁰⁰. Dëshmitari B dëshmoi se personat me

⁹⁵ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 27 shkurt 2015, faqet 5-6, 10-11, Tab 9, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Shih gjithashtu Proces-verbalin e Seancës së Dëgjimit të Dëshmitarit në Procedurën Paraprake, Dëshmitari B, 24 qershor 2014, f. 3, ZARFI I VULOSUR; Proces-verbalin e Seancës së Dëgjimit të Dëshmitarit në Procedurën Paraprake, Dëshmitari B, 27 nëntor 2014, f. 5, ZARFI I VULOSUR;

⁹⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 01 prill 2015, faqe 5, Tab 5, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI V; Shih gjithashtu Hartën me Pikat A dhe B bashkëngjitur Proces-verbalit të Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁹⁷ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 17 mars 2015, faqe 35, Tab 2, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

⁹⁸ Po të vraponte me shpejtësi 10km/orë, të Pandehurit do t'i duheshin 4 minuta e 15 sekonda të mbërrinte në pikën B (depoja);

⁹⁹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 27 shkurt 2015, faqet 9-12, Tab 9, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

¹⁰⁰ Shih Proces-verbalin e Seancës së Dëgjimit të Dëshmitarit në Procedurën Paraprake, Dëshmitari B, 24 qershor 2014, faqe 3, ZARFI I VULOSUR; Proces-verbalin e Seancës së Dëgjimit të Dëshmitarit në Procedurën Paraprake, Dëshmitari B, 27 nëntor 2014, faqet 4-5, 8, ZARFI I VULOSUR;

armë zjarri ishin afër depos.¹⁰¹ Dhe në fund Dëshmitari B tha se ai/ajo pa vetëm rreth 10 persona në atë vend dhe në atë kohë.¹⁰²

87. Prandaj motivi i të pandehurit për të shkuar në atë vend ishte pjesë e një plani paraprak të organizuar shumë mirë, gjë që të gjithë dëshmitarët që dëshmuuan dhe konfirmuan alibinë e të pandehurit, e fshehin dhe gënjejnë në lidhje të, konkretisht Dëshmitari S. V., Dëshmitari Z. J., Dëshmitari Z. M., Dëshmitari S. V., Dëshmitari M. K., Dëshmitari Z. D. dhe Dëshmitari D. D.¹⁰³ Kjo provon se këta dëshmitarë nuk janë të pavarur, duan të ndihmojnë të Pandehurin dhe për këtë arsye nuk kanë besueshmëri në lidhje me kohën e saktë të mbërritjes së të Pandehurit në depo.

88. Së dyti, ka mospërputhje lidhur me numrin e personave të cilët ishin të pranishëm në afërsi të depos në ditën e incidentit. Dëshmitari B dëshmoi se ishin vetëm 10 persona,¹⁰⁴ ndërsa të gjithë dëshmitarët që dëshmuuan në favor të alibisë së të Pandehurit, deklaruan se afër depos ishin deri në njëqind persona.¹⁰⁵ Asnjëri prej këtyre dëshmitarëve nuk përmendi se ka pasur civilë të cilët mbanin armë zjarri, siç u deklarua nga dëshmitari B.

89. Këto mospërputhje ndërmjet deklaratave të Dëshmitarit B dhe Dëshmitarit të alibisë janë serioze. Ato nuk mund të zgjidhen me mjete të tjera provuese, dhe shkatërrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të bazuar besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve.

90. Kështu, edhe një detaj i vogël, përkatësisht koha e mbërritjes së të Pandehurit **R. R.** në depo, nuk mund të provohet me ato deklarata.

¹⁰¹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 27 shkurt 2015, faqe 9, Tab 9, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Shih Proces-verbalin e Seancës së Dëgjimit të Dëshmitarit në Procedurën Paraprake, Dëshmitari B, 27 nëntor 2014, faqet 5, ZARFI I VULOSUR;

¹⁰² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 27 shkurt 2015, faqet 9-10, Tab 9, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

¹⁰³ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 17 mars 2015, faqet 25-42, 43-51, Tab 2, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqet 3-15, 16-29, 30-36, 36-46. 47-57, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

¹⁰⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 27 shkurt 2015, faqet 9-10, Tab 9, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

¹⁰⁵ Dëshmitari S. V. deklaroi: “Shumë njerëz. Unë nuk i numërova por rreth 100 vetë”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 17 mars 2015, faqe 27, Tab 2, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Dëshmitari Z. J. deklaroi: “Nuk e di me saktësi sa njerëz ishin atje, por sipas vlerësimit tim të lirë ishin rreth 50-100, turma ishte e madhe”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 17 mars 2015, faqe 47, Tab 2, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Dëshmitari Z. M. deklaroi: “Sipas vlerësimit tim ishin më pak se 100 vetë, afërsisht rreth 80 vetë. Harrova të cek se disa persona po vraponin nga drejtimi i depos në drejtim të Zubin Potokut”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqe 5, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Dëshmitari S. V. deklaroi: “S. V.: Nuk e di me saktësi por ishin shumë. Burhan Maxhuni: Afërsisht? S. V.: Tridhjetë, dyzet, pesëdhjetë vetë, nuk i numërova”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqe 21, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Dëshmitari M. K. deklaroi: “Ishin 200 a 300 vetë, ishin shumë njerëz dhe ishin rreth 50 deri në 100 automjete dhe e gjithë rruga ishte e bllokuar”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqe 32, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Dëshmitari Z. D. deklaroi: “Vërtet nuk më kujtohet kush ishin në këtë turmë ose kë pyeta. Po zhvillohej vërtet shpejt”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqe 41, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Dëshmitari D. D. deklaroi: “Nuk e di numrin e saktë sepse ishte një grup i madh njerëzish”, Shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqe 50, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

91. Megjithatë, Gjykata nuk mund ta përdorë këtë alibi të falsifikuar për të arritur në përfundimin se i Pandehuri ishte në barrikadë. Barra e provës në lidhje me këtë fakt i mbetet Prokurorisë edhe në rast se i Pandehuri ka gënjyer në lidhje me këtë çështje.

D.2. Provat materiale të paraqitura në lidhje me të Pandehurin R. R.

92. Gjykata e gjeti të qartë se as kjo provë materiale nuk është bindëse.

93. Nga numri i telefonatave të bëra nga i Pandehuri **R. R.** para, gjatë dhe pas incidentit,¹⁰⁶ Gjykata mund të dyshojë se i Pandehuri ishte kryesisht aktiv gjatë asaj dite, por, pa përmbajtjen e atyre bisedave apo mesazheve të dërguara, ai dyshim nuk mund të provohet. Shkresat e lëndës nuk përmbajnë ndonjë mesazh apo bisedë që mund ta vendoste të Pandehurin në barrikadë, ose të tregonte se ai mori pjesë në organizimin e kësaj barrikade. Trupi Gjykues mund të ketë dyshime për shkak të numrit të madh të telefonatave dhe mesazheve të bëra dhe të dërguara nga i Pandehuri atë ditë (69 në total¹⁰⁷), si dhe kohës kur u bënë këto thirrje telefonike dhe kur u dërguan ato mesazhe.¹⁰⁸ Megjithatë, pa ndonjë provë rreth përmbajtjes së tyre, ky fakt, i vetëm ose në lidhje me të tjerë, nuk mund të zbulojë ndonjë veprim kriminal të të Pandehurit.

94. Për më tepër, matja e pozicionit të telefonit të të Pandehurit **R. R.** atë ditë mundi të jetë provë vendimtare dhe përkatëse.

95. Sipas radio komunikimeve, sulmi ndodhi në orën 14:15 dhe të shtënat u zhvilluan për të paktën 15 minuta.¹⁰⁹

96. Sipas identifikimit celular të telefonit (provat materiale të paraqitura gjatë Shqyrtimit Gjyqësor të datës 20 mars 2015), më 26 korrik 2011, midis orës 14:13 dhe orës 14:17, telefoni i të pandehurit **R. R.** ishte nën antenën në Zupçe (nr. 11.574).¹¹⁰ Megjithatë, në orën 14:18, telefoni i të Pandehurit përdori antenën në Zubin Potok (nr. 11.503).¹¹¹ Në orën 14:23, telefoni i tij përdori përsëri antenën në Zupçe.¹¹²

¹⁰⁶ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 qershor 2014, faqet 18-22, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹⁰⁷ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 qershor 2014, faqet 19-22, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹⁰⁸ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 qershor 2014, faqet 19-22, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹⁰⁹ Raport përmbledhës për ngjarjet e datave 25/26/27-07-2011, faqe 171, Dosja e Prokurorisë I;

¹¹⁰ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 qershor 2014, faqe 21, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/Dosja e CD-së së matjeve telefonike; Shih gjithashtu Hartën e Antenave, faqe 51, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹¹¹ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 qershor 2014, faqe 21, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹¹² Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 qershor 2014, faqe 21, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

97. Për rrjedhojë, nga këto prova materiale Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se i Pandehuri **R. R.** ishte në vendin e pritës në kohën e sulmit kundër autokolonës së _____.

98. Gjithashtu, ky element nuk mund të jetë plotësisht i mbështetshëm, sepse raporti i Policisë i paraqitur nga Prokuroria deklaroi se, pa intensitetin e sinjalit të antenave, pozita e telefonit nuk është e saktë.¹¹³

99. Krahas kësaj, Gjykata duhet të theksojë se, në bazë të hartës së paraqitur nga kompania telefonike serbe, vendi ku ndodhet depoja është pak a shumë në mes të dy antenave relevante, domethënë antenës nr. 11.574 dhe antenës nr. 11.503.¹¹⁴

100. Prandaj Gjykata arriti në përfundimin se ajo nuk mund të jetë e sigurt në lidhje me vendndodhjen e saktë të telefonit të të Pandehurit **R. R.** më 26 korrik 2011, pa të dhëna të tjera teknike plotësuese. Gjykata veçanërisht thekson se të dhënat e paraqitura në raportin e Policisë së EULEX-it tregojnë një lëvizje të çuditshme që nuk është në pajtim me pjesën tjetër të fakteve të provuara (se i pandehuri ishte në barrikadë deri në orën 14:17, pastaj u zhvendos në depo, dhe pastaj, para se të përfundonin të shtënat, ai shkoi përsëri në barrikadë).

D.3. Pjesa tjetër e provave

101. Gjatë deklaratës së saj përfundimtare, Prokuroria paraqiti dy argumente të tjera në lidhje me sjelljen e të Pandehurit **R. R.** pas nisjes dhe përfundimit të sulmit kundër autokolonës së _____ së Kosovës.

102. Në radhë të parë, Gjykata duhet të theksojë se prova është mjet i demonstrimit të një fakti të panjohur nga një situatë apo realitet i njohur. Megjithatë, në bazë të rregullave ose procedurave të caktuara duhet bërë një arsyetim logjik. Fakti i njohur duhet të jetë i sigurt. Së dyti, pastaj ky fakt duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me faktin e panjohur. Së treti, mbështetshmëria në këtë procedurë të provave varet nga një numër faktesh, nga numri i konkluzioneve logjike dhe shkalla e sigurisë së vërtetësisë së tyre.

103. Prandaj, nga fakti se i Pandehuri deklaroi se ai shkoi për peshkim pas sulmit ndaj autokolonës së _____ së Kosovës, Gjykata nuk mund të konkludojë se ai ishte vërtet në vendin e ngjarjes. Para së gjithash, Gjykata duhet të theksojë se, sipas një raporti të policisë në shkresat e lëndës, policia u informua për vdekjen e _____ E. Z., në orën 22:20 të datës 26 korrik 2011.¹¹⁵ Nga kjo provë, Gjykata arriti në përfundimin se, gjatë asaj pasdite, askush nuk mund të kishte ditur se vdekja e tij u shkaktua nga veprimet e ndërmarra nga ana e personave në barrikadë dhe personat të cilët shtinë.

¹¹³ Raportin e Policisë së EULEX-it, 16 maj 2014, faqet 41-43, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹¹⁴ Shih Hartën e Antenave, faqe 51, Dokumente shtesë të prokurorisë/Raporte të policisë/ Dosja e CD-së së matjeve telefonike;

¹¹⁵ Raport Përmbledhës për Ngjarjet e datave 25/26/27-07-2011, faqe 171, Dosja e Prokurorisë I;

104. Po kështu, nga fakti se, pas ngjarjes, i Pandehuri **R. R.** u tregoi oficerëve të policisë vendin ku ndodhej barrikada, Gjykata nuk mund të konkludojë se vetë ai ishte në barrikadë në kohën e sulmit.

105. Me siguri pothuajse e gjithë popullata e Zubin Potokut e dinte vendin ku ndodhej barrikada. Kjo nuk është provë e kryerjes së ndonjë vepre penale. Përkundrazi, kjo mund të kishte qenë provë relevante në rast se vendi i kryerjes së veprave penale do të ishte sekret ose i pazbuluar. Megjithatë, në këtë rast, ku fishekë dhe vetura ndodheshin në një magjistrale publike, në një vend ku kushto mund të kishte kaluar duke ecur, nuk është.

106. Për më tepër, fakti që pandehuri **R. R.** shkoi në Mal të Zi fill pas kësaj ngjarjeje, nuk mund ta çojë Gjykatën në përfundimin se ai ishte në barrikadë. Kjo mund të ngrejë dyshime; por vetëm ky fakt nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me akuzat konkrete penale.

107. Së fundi, fakti që i Pandehuri është gjithashtu i dyshuar në procedura të tjera penale, nuk mund të përdoret deri sa të jetë shqiptuar një aktgjykim i formës së prerë në ato procedura, për të vërtetuar se ai ishte në barrikadë. Po të veprohet kështu, kjo do të ishte shkelje e nenit 3 të KPP-së.

D.4. Provat e sjella nga dëshmitarët

108. Pas gati katër vitesh që nga koha kur ndodhën ngjarjet, e vetmja provë e vërtetë e sjellë kundër të Pandehurit **R. R.** është deklarata e dëshmitarit F. U. dhe deklarata e Dëshmitarit B.

109. A mundet gjykata të vlerësojë fajësinë e të Pandehurit **R. R.** me deklaratën e vetëm një dëshmitari? Që ta bëjë këtë, ai dëshmitar duhet të jetë plotësisht i mbështetshëm për të arritur një shkallë të sigurisë pa asnjë dyshim të arsyeshëm.

110. Në radhë të parë, Trupi Gjykses duhet të theksojë se deklarata e dëshmitarit F. U. ishte e drejtpërdrejtë dhe e besueshme. Disa detaje që ai i tregoi Gjykatës përputhen, për shembull, fakti që Dëshmitari F. U. e ndaloi të Pandehurin **R. R.** ndërsa ai po ngiste një Skoda të kuqe disa javë para se të ndodhte incidenti¹¹⁶ dhe fakti se dëshmitarët e "alibisë" i

¹¹⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqet 12, 23-24, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II; F. U. gjithashtu deklaroi: "Gjithashtu ishte edhe një tjetër, mbiemri **R. ose R.**, emri i babait është T.. Unë e kam parë këtë person, ai ka vozitur një Skoda të kuqe me tablla serbe të Kraljevos, e kam ndaluar atë më parë. Ka qenë një Skoda e kuqe. Unë nuk shkrova ndonjë gjë për këtë person, ishte thjesht një ndalim i rëndomtë trafikut"; shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 29 korrik 2011, faqe 1822, Dosja e Prokurorisë V; "Po, personi i përfaqësuar në foton nr. 1 të foto-albumit është ai që tregova në intervistat e mia të mëparshme si **R. ose R.**, ky është mbiemri i tij por nuk më kujtohet emri i tij. Zakonisht ai voziste një Skoda të kuqe me tablla serbe KV nga Kraljevo. E njihja që përpara incidentit. Në veçanti, sic ka deklaruar tashmë në intervistat e mëparshme, në korrik 2011, nuk më kujtohet data e saktë, ndërsa isha në shërbim në magjistralen ndërmjet Prishtinës dhe Mitrovicës, afër varrezave serbe, e ndalova atë për një kontroll normal të trafikut, me atë rast isha në

thanë gjykatës se vetura e **R. R.** ishte një Skoda e kuqe, e cila ishte parkuar pranë depos në ditën e ngjarjeve.¹¹⁷

111. Nga njëra anë, Gjykata e çmon të rëndësishme se identifikimi i të Pandehurit **R. R.** nga dëshmitari F. U. u bë duke u bazuar në faktin se ai njihej që më parë nga dëshmitari. Në të vërtetë, Dëshmitari F. U. e identifikoi të pandehurin **R. R.** në barrikadën e dytë, bazuar në faktin e pretenduar se ai e kishte ndaluar atë ndërsa ishte duke vozitur një Skoda të kuqe një muaj para se të ndodhnin ngjarjet. Prandaj Gjykata vlerëson se kjo është më e mbështetshme se sa një identifikim i thjeshtë.

112. Gjykata thekson se askush nuk deklaroi se sa persona ndalon F. U. çdo muaj në cilësinë e tij si _____. Megjithatë, dihet për Gjykatën se këto operacione janë zakonisht të shumta, zgjasin shkurt, dhe shoferi zakonisht nuk ka largohet nga automjeti i tij.

113. Nga ana tjetër, ndërsa e identifikoi të pandehurin **R. R.** si person i cili ishte në barrikadë, Dëshmitari F. U. bëri gabime të shumta në lidhje me emrin e të Pandehurit, emrin e babait të të Pandehurit¹¹⁸ dhe ngjyrën e flokëve të tij (kur F. U. deklaroi se personi që ai pa në barrikadë, ishte flokëverdhe ose gjysmë flokëverdhe, ndërsa i Pandehuri ka flokë ngjyrë kafe).¹¹⁹

114. Përveç kësaj, Dëshmitari F. U. pranoi në deklaratat e tij fillestare se ai u fokusua tek personat në barrikadë të cilët nuk i njohte që më parë, me qëllim që të ishte në gjendje t'i identifikonte ata në të ardhmen.¹²⁰

shërbim me të ndjeri, _____ E. Z.”; shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V;

¹¹⁷ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 17 mars 2015, faqet 40, 45, Tab 2, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV; Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 18 mars 2015, faqet 20, 49-50, Tab 4, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

¹¹⁸ F. U. deklaroi: “një person me mbiemrin **R.** ose **R.**, nga fshati Zupce, djali i T. (T.), e kalon kohën e tij në pompën e gazit “TIM-PETROL”, ka në pronësi një automjet SKODA të kuqe”; shih Deklaratën e Dëshmitarit F. U., 26 korrik 2011, faqe 1813, Dosja e Prokurorisë V; F. U. deklaroi më tutje: “Gjithashtu ishte edhe një tjetër, mbiemri **R.** ose **R.**, emri i babait është T. Unë e kam parë këtë person, ai ka vozitur një Skoda të kuqe me tablla serbe të Kraljevos, e kam ndaluar atë më parë. Shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 29 korrik 2011, faqe 1822, Dosja e Prokurorisë V; “Gjithashtu njoha një person mbiemri i të cilit është **R.** ose **R.** dhe ai është i afërt me një person me emrin T. nga fshati Zupce”, Shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 05 gusht 2011, faqe 1840, Dosja e Prokurorisë V; “Po, personi i përfaqësuar në foton nr. 1 të foto-albumit është ai që tregova në intervistat e mia të mëparshme si **R.** ose **R.**, ky është mbiemri i tij por nuk më kujtohet emri i tij”; shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V;

¹¹⁹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqet 15, 24, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II; F. U. gjithashtu deklaroi: “Ai ishte biond, jo krejt por biond”; shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 05 gusht 2011, faqe 1840, Dosja e Prokurorisë V;

¹²⁰ F. U. deklaroi: “meqë nuk i kisha parë apo takuar ata më parë, u përqendrova tek ata me qëllim që t'i identifikoja në të ardhmen”; shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V;

115. Gjithashtu, Gjykata nënvizon se ngjarjet që ndodhën atë ditë zgjatën për një periudhë të shkurtër kohe dhe se _____ ishin nën një situatë shumë stresante.

116. Për të gjitha këto arsye, Gjykata çmon se identifikimi i **R. R.** i bërë nga dëshmitari F. U. duhet cilësuar si provë e dobët, sepse gjatë këtij identifikimi u bënë gabime të rëndësishme në lidhje me elementet kryesore që kanë të bëjnë me identitetin e të pandehurit, përkatësisht emrin e tij, emrin e babait të tij dhe ngjyrën e flokëve të tij.

117. Për më tepër, Gjykata nënvizon se identifikimi dhe përshkrimi i bërë nga dëshmitari F. U. gjatë fazës hetimore ishte i rëndësishëm dhe relevant, sepse përshtatej me emrat dhe përshkrimin e dy individëve, përkatësisht **V. R.** dhe **R. R.** ¹²¹ Kështu që ishte identifikimi i bërë me përdorimin e foto-albumeve ai që ishte vendimtar për identifikimin e të Pandehurit në këtë lëndë.¹²²

118. Krahas kësaj, Gjykata vëren se aftësia e Dëshmitarit F. U. për të identifikuar të Pandehurin është e spikatur. _____ I. A.,¹²³ i cili doli nga automjeti në ditën e ngjarjeve dhe, për këtë arsye, kishte shikueshmëri të mirë, identifikoi vetëm një person me siguri 70%.¹²⁴ Në mënyrë të ngjashme, shoferi i së njëjtës veturë¹²⁵ u fokusua vetëm tek një person.¹²⁶ Megjithatë Dëshmitari F. U. që në gjendje të identifikojë katër persona gjithsej, të cilët ai i njohte që më parë, dhe arriti të përqendrohet tek dy persona të cilët ai nuk i kishte njohur më parë.

119. Përshkrimi nga F. U. i të Pandehurit është se **R. R.** ishte biond, jo krejtësisht, por biond.¹²⁷ Në gjuhën shqipe, biond mund të thotë e bardhë, por asnjëherë nuk do të thotë kafe. Përveç kësaj, është e qartë nga fotografia e të Pandehurit, që ishte pjesë e foto-

¹²¹ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 05 gusht 2011, faqet 400-401, Dosja e Prokurorisë II;

¹²² Shih Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit F. U., 05 gusht 2011, faqe 1842, Dosja e Prokurorisë V;

¹²³ Dëshmitari I. A. deklaroi: “Pata shikueshmëri shumë të mirë sapo që ata i vendosën automjetet atje dhe dolën nga automjetet. Kur u afrova më tutje, i pashë edhe më mirë. Ata qëndronin jashtë veturave”; shih Proces-verbalin e Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqe 14, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

¹²⁴ Dëshmitari I. A. deklaroi: “Po. (Dëshmitarit iu treguan 6 foto-albume që ishin përgatitur nga Hetuesi). Mendoj se foto-albumi 2 nga albumi numër 1 ishte personi që doli nga njëri prej automjeteve që kishin bllokuar rrugën. Mund të them me 70% se ky ishte personi që pashë, për shkak të fytyrës dhe flokëve të tij, që kanë mbetur në kujtesën time”, Shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit I. A., 05 gusht 2011, faqe 2785, Dosja e Prokurorisë VII;

¹²⁵ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqe 7, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

¹²⁶ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 12 mars 2015, faqet 24, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI IV;

¹²⁷ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqet 15, 24, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II; F. U. gjithashtu deklaroi: “Ai ka flokë biond, jo totalisht por biond”; shih Proces-verbalin e Intervistimit të Dëshmitarit, F. U., 05 gusht 2011, faqe 1840, Dosja e Prokurorisë V;

albumeve të përdorura nga Prokuroria gjatë fazës së hetimit kur mori në pyetje dëshmitarët, se i pandehuri **R. R.** kishte flokë ngjyrë kafe.¹²⁸

120. Së treti, F. U. tha se në barrikadë ishin pesë vetura.¹²⁹ Sipas Dëshmitarit I. A., ishin vetëm tre vetura gjithsej.¹³⁰ Ky nuk është një detaj i vogël, sepse në këtë lëndë të dyshuarit erdhën me vetura, i lanë veturat në rrugë dhe pastaj ulëritën dhe bërtitën në afërsi dhe në pjesën e prapme të këtyre veturave. Si rezultat i kësaj, këto vetura që formonin barrikadën, duhej të ishin gjithmonë në fushë-pamjen e dëshmitarëve.

121. Për sa i përket moshës së personave të pranishëm në barrikadë, dëshmia e Dëshmitarit F. U. është e ndryshme nga dëshmia e Dëshmitarit I. A.. F. U. tha se disa persona ishin ndërmjet 30 dhe 40 vjeç¹³¹; ky i fundit se *“ata nuk ishin të vjetër, ata ishin të rinj. [...] Ata mund të ishin 20-25; mbi 20”*.¹³²

122. Së fundi, është problemi se Dëshmitari F. U. nuk e përshkroi fizikisht të pandehurin që ishte, sipas tij, i pranishëm në barrikadë, para se Dëshmitarit t'i tregoheshin foto-albumet me fotografitë e të dyshuarve, përfshirë **R. R.**.

123. Prandaj Gjykata mund të konkludojë se deklarata e Dëshmitarit F. U. është relevante dhe e ndershme, por e vetme ajo nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshem se i Pandehuri **R. R.** ishte në barrikadë në ditën e sulmit.

124. Dyshimet e ngritura në lidhje me numrin e veturave në barrikadë, ngjyra e flokëve të Pandehurit, moshja e personave në barrikadë, dhe gabimi në lidhje me emrin e të Pandehurit dhe të babait të tij, janë të rëndësishme dhe nuk mund të zgjidhen duke përdorur ndonjë provë tjetër.

125. Për më tepër, fakti që Dëshmitari F. U. e kishte ndaluar të Pandehurin disa javë para ngjarjeve në një kontroll rutinë trafikë, është i rëndësishëm dhe forcon vlerën e deklaratave të tij. Megjithatë Gjykata konstatoi se ajo nuk është e mjaftueshme për të fshirë këto dyshime. Ky ishte një takim i izoluar që zgjati disa çaste. Gjykata thekson përsëri se përshkrimi që bëri Dëshmitari F. U. mund të përputhet me dy persona të ndryshëm.¹³³

¹²⁸ Shih foto-albumin nr. 6, foton nr. 1, faqe 1849, Dosja e Prokurorisë V; Gjithashtu Gjykata duhet të theksojë se personi i dytë që mund të përputhej me elementet e treguara nga z. F. U. gjithashtu ka flokë të kaftë, dhe është përfshirë në foto-albumin nr. 2, foton nr. 2; shih foto-albumin 2, faqe 1845, Dosja e Prokurorisë V. Prandaj problemi i ngjyrës së flokëve nuk mund të shpjegohet me dritën e diellit ose me faktin se flokët ishin të shkurtër, sepse kjo ndodhi dy herë ndy raste të ndryshme;

¹²⁹ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 20 janar 2015, faqet 6-7, Tab 23, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI II;

¹³⁰ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqe 8, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III; Shih gjithashtu Skicën e vizatuar nga I. A., faqe 2780, Dosja e Prokurorisë VII;

¹³¹ Shih Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, F. U., 05 gusht 2011, faqe 1840, Dosja e Prokurorisë V;

¹³² Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqe 13, Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

¹³³ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 05 gusht 2011, faqet 400-401, Dosja e Prokurorisë II;

Gjykata vëren se edhe personi tjetër, domethënë **V. R.**, ka flokë ngjyrë kafe¹³⁴ dhe se asnjë person nuk ishte përfshirë në foto-albumet që iu treguan dëshmitarit.¹³⁵

126. Së fundi, Gjykata duhet të theksojë se identifikimi i bërë nuk është plotësisht i mbështetshëm. Po të shikojmë fotografitë e të dyshuarve në foto-albumin në të cilën është e pranishme fotoja e të pandehurit **R. R.**, nga të gjashtë personat e pranishëm në album, mund të shohim se një person ka veshur syze të errëta,¹³⁶ një person tjetër ka veshur një kapelë,¹³⁷ dhe tre personat e të tjerë të mbetur kanë mjekra.¹³⁸ Për më tepër, në qoftë se i njëjti album do të ishte përgatitur me qëllimin që ta bënte Dëshmitarin të identifikonte një person biond, Gjykata e gjen të paktën paksa të çuditshme që atje nuk është përfaqësuar asnjë person biond, kur ky ishte një element kyç në përshkrimin e mëparshëm të dhënë nga F. U..

127. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, provat e besueshme të dëshmitarit pamor janë vendimtare në një hetim dhe ndjekje penale, dhe ato luajnë rol të fuqishëm brenda sistemit të drejtësisë penale. Zbulimi i përsëritur i identifikimeve të gabuara që kanë kontribuar për caktimin e dënimeve të gabuara, ka nxitur hetime lidhur me natyrën e provave të dëshmitarëve pamorë. Në Shtetet e Bashkuara, mbi 230 njerëz,¹³⁹ të cilët kanë shërbyer mesatarisht 12 vjet burgim, janë shfajësuar përmes testimi të ADN-së dhe 75% e këtyre dënimeve të gabuara (179 raste të veçanta në kohën e këtij shkrimi) përfshinin identifikim të gabuar nga dëshmitarë pamorë. Në 50% të rasteve të identifikimit të gabuar, dëshmitë e dëshmitarëve pamorë ishin provat qendrore të përdorura kundër të pandehurve (pa prova të tjera vërtetuese, të tilla si rrëfime të fajësisë, dëshmi të shkencës mjeko-ligjore ose të informatorëve). Studimet kanë treguar se prania e armës rrit nivelet e stresit dhe zvogëlon gjasat e identifikimit të mbështetshëm.¹⁴⁰ Dhe dihet tashmë se kjo traumë ndikon në besueshmërinë e njohjes ose të identifikimit.

128. Në këtë rast, Gjykata nënvizon se sulmi që ndodhi më 26 korrik 2011 ishte një situatë shumë stresante, me pasojë traumatike për _____ të pranishëm gjatë pritës. Gjykata vërejt se disa nga dëshmitarët të cilët erdhën për të dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ishin shumë emocionalë teksa dëshmonin për ato ngjarje që zgjatën vetëm 15 minuta.

¹³⁴ Shih Raportin e Policisë së EULEX-it, 05 gusht 2011, faqet 402-403, Dosja e Prokurorisë II;

¹³⁵ Shih foto-albumet, faqet 1844-1849, Dosja e Prokurorisë V;

¹³⁶ Shih Foton nr. 5, foto-albumi nr. 6, faqe 1849, Dosja e Prokurorisë V;

¹³⁷ Foto nr. 4, foto-albumi nr. 6, faqe 1849, Dosja e Prokurorisë V;

¹³⁸ Fotot nr. 2, 3 dhe 6, foto-albumi nr. 6, faqe 1849, Dosja e Prokurorisë V;

¹³⁹ Shih B. N. Cardozo, "Rivlerësimi i Rreshtimeve për Identifikim: Përse dëshmitarët bëjnë gabime dhe si të ulen gjasat e identifikimit të gabuar", në http://www.innocenceproject.org/files/imported/eyewitness_id_report-5.pdf.

¹⁴⁰ C.J. Stanny dhe T.C. Johnson, "Efektet e Stresit të Shkaktuar nga një Shtënë e Simuluar në Kujtesën e Dëshmitarëve të Policisë dhe Qytetarë", *Revista Amerikane e Psikologjisë* 113, 359-386.

129. Të gjithë këta faktorë bëjnë që Gjykata që të jetë e kujdesshme dhe e matur në lidhje me identifikimin e ndonjë të pandehuri të bërë nga një dëshmitar i vetëm.

130. Në intervistën e tij në procedurën paraprake, Dëshmitari I. A. deklaroi se ai mundi të dallojë një person të veshur me një këmishë të zezë, kur iu treguan fotografi të të dyshuarve, dhe tha se ky person ishte në foton nr. 2. Ai tha: “Ky ishte personi që pashë, për shkak të fytyrës dhe flokëve, që kanë mbetur në kujtesën time”, por këtë mund vetëm ta themi me 70% sigurisë.¹⁴¹

131. Se personi në fjalë nuk ishte asnjëri prej të pandehurve në këtë lëndë. Sigurisht _____, si _____, për mbajtjen mend të fytyrave kishte të njëjtin trajnim si dëshmitari F. U., por ai ishte vetëm 70% i sigurt në lidhje me identifikimin. Prandaj, është e qartë se gjykata nuk mund të gjejë përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri R. R. ishte në barrikadë vetëm në bazë të deklaratës së Dëshmitarit F. U..

III. GJETJET LIGJORE

132. Parimi bazë i së drejtës penale është se çdo përgjegjësi penale varet nga një veprim apo mosveprim i shkaktuar nga i pandehuri (neni 1 i KPK-së dhe KPRK-së). Kjo “kërkesë e veprimit”¹⁴² nuk ekziston në këtë lëndë. Nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ndonjëri nga të pandehurit kishte bërë ndonjë lëvizje, gjest apo formë të komunikimit njerëzor që çoi në vrasjen e E. Z., ose ndonjërin nga akuzat e tjera penale.

133. Prandaj, në bazë të nenit 364 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.3) të KPP-së, të Pandehurit duhet të lirohen nga akuzat se kanë kryer këto vepra penale:

1. vrasje e rëndë, në shkelje të neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1.7), (1.9) dhe (1.10) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së ;

2. vrasje e rëndë në tentativë, në shkelje të neneve 146 dhe 147 (4), (6), (8) dhe (10) të KPK-së, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së, *pari materia* me nenet 178 dhe 179 (1.5), (1,7), (1,9) dhe (1,10) të KPRK-së, lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së ;

3. mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 328 (1) dhe (2) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 374 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së ;

¹⁴¹ Shih Proces-verbal i Intervistimit të Dëshmitarit, I. A., 05 gusht 2011, faqe 2785, Dosja e Prokurorisë VII.

¹⁴² Shih F. Muñoz-Conde dhe L. Ernesto Chiesa, *Kërkesa e Veprimit si Koncept Bazë i së Drejtës Penale*, Cardozo Law Review, 28 CDZLR 2461, maj 2007.

4. pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, në shkelje të nenit 316 (1) dhe (3) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 409 (1) dhe (2) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së ;

5. rrezikim i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme, në shkelje të Nenit 299 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së ;

6. shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, në shkelje të Nenit 291 (1), (3) dhe (5) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së ;

7. pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale, në shkelje të Nenit 320 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 412 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

3.1. Lidhur me akuzat e “rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme” dhe “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm”

134. Analiza e mëposhtme ka të bëjë me akuzat e “rrezikimit të trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme”, në shkelje të Nenit 299 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm”, në shkelje të Nenit 291 (1), (3) dhe (5) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

135. Trupi Gjykses thekson se edhe nëse gjetjet faktike mund t'i vendosin të pandehurit në barrikadë, do të arrihej i njëjti përfundim.

136. Në radhë të parë, midis këtyre dy dispozitave ligjore ekziston një lidhje bashkimi.

137. Bashkimi real i veprave lind kur i akuzuari kryen më shumë se një krim, duke shkelur të njëjtën dispozitë disa herë, ose duke shkelur një numër dispozitash të ndryshme me veprime të veçanta.

138. Bashkimi real i dukshëm mund të lindë kur një sërë veprimesh të ndara, por të lidhura ngushtë, përmbushin të gjitha elementet e një veprë të caktuar penale, por konsiderohen si një krim i vetëm, ndonëse i vazhdueshëm. Bashkimi ideal lidhet me situatën ku një veprim i vetëm ose gjendje faktike e vetme përbën më shumë se një krim.

139. Për më tepër, bashkimi i dukshëm ideal i veprave penale lind kur lidhja e bashkimit zgjidhet me zbatimin e metodave të mëtejshme analitike. Pikënisja e kësaj analize është krahasimi i elementeve të ndryshme të krimeve me qëllim që të përcaktohet veçantia e

ndërsjellë. Parimi i subsidiaritetit zbatohet si metodë shtesë për të përcaktuar rregullsinë e dënimeve kumulative për bashkimin ideal. Subsidiariteti ka të bëjë me lidhjet ndërmjet veprave të të njëjtit lloji, që kanë për synim të mbrojnë interesa sociale të njëjta ose të lidhura ngushtë, por që ndryshojnë në lidhje me elemente të veçanta. Në rrethana të tilla, krimi i veçantë konsumon krimin e përgjithshëm.

140. Në Aktakuzë, megjithatë, prokurori e ka përdorur parimin e bashkimit të dukshëm real pa ndonjë qëllim të dukshëm. Për një veprim, të Pandehurit janë akuzuar për dy krime, edhe nëse klauzola e përgjithshme e “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm” tashmë është përfshirë dhe mishëruar në elementet e nenit 299 të KPK-së. Prandaj, i njëjti rezultat (rrezikimi) përdoret në dy dispozita të ndryshme.

141. Gjykata duhet të theksojë se vepra penale e paraparë në nenin 291 të KPK-së paraqet vepër penale të përgjithshme në lidhje me veprat e tjera penale në këtë kapitull, që manifestohet në forma të veçanta, d.m.th. aspekte të veçanta të kësaj vepre të përgjithshme penale. Gjegjesisht, vepra penale e “shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm” përmban edhe karakteristikat e rëndësishme të nenit 299 të KPK-së. Të dy krimet dënojnë shkeljet me të njëjtën vlerë penale (rrezikimin e jetës ose trupit të personave ose pasurinë e konsiderueshme, jo vetëm me veprimtaritë ose mjetet e deklaruar shprehimisht në ligj), por edhe me veprim të formave të ndryshme (një “me një tjetër” veprimtari përgjithësisht e rrezikshme ose me mjete përgjithësisht të rrezikshme, një tjetër me një përshkrim të plotë të formës së veçantë të veprimeve).

142. Karakteri subsidiar i kësaj vepre (neni 291 i KPK-së) rrjedh edhe nga karakteri i saj i përgjithshëm, sepse ajo ekziston vetëm në rast se në një rast konkret nuk janë përmbushur karakteristikat ligjore të një vepre tjetër penale nga të dy kapitujt.

143. Prandaj Gjykata mund të arrijë në përfundimin se kemi një bashkim të dukshëm bazuar në subsidiaritetin e këtyre dy dispozitave penale.

144. Për më tepër, në lidhje me këtë akuzë (“rrezikimi i trafikut publik me veprim apo me mjete të rrezikshme”), Trupi Gjykues duhet të theksojë se asnjë fakt nuk u provua që mund të demonstronte se të pandehurit, edhe nëse ata ishin në barrikadë, kryen ndonjë veprim kriminal.

145. Kjo është kështu sepse Neni 299 i KPK-së (Neni i Rrezikimit të Trafikut Publik me Veprim apo me Mjete të Rrezikshme) thotë:

“(1) Kushdo që asgjëson, heq ose dëmton rëndë instalimet, pajisjet, shenjat apo sinjalizimet që shërbejnë për sigurinë e trafikut, jep shenja ose sinjale të gabueshme, vë pengesa në rrugët publike apo në ndonjë mënyrë tjetër e rrezikon trafikun dhe kështu vë në rrezik jetën e njeriut, sigurinë fizike apo pasurinë në përmasa të mëdha dënohet me burgim deri në tri vjet”.

146. Elementi objektiv i kësaj dispozite penale është një veprim që mund të shkaktojë rrezik të përgjithshëm konkret (real dhe të menjëhershëm) për jetën ose trupin e personave ose pasurinë në përmasa të konsiderueshme. Në këtë lëndë, i vetmi veprim i kryer nga personat të cilët ishin në barrikadë ishte formimi i një pengese konkrete ndaj autokolonës së _____. Kjo barrikadë në vetvete nuk shkaktoi ndonjë rrezik konkret ndaj _____. Ishin të shtënat me armë zjarri dhe ngritja e pritës ato që vranë E. Z. dhe vunë në rrezik personat që ishin në autokolonën e _____. Prandaj, pa një lidhje të fortë ndërmjet të shtënave dhe barrikadës, të pandehurit nuk mund të ishin kryerës të këtyre dy akuzave penale.

147. Prandaj, në bazë të nenit 364 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.3) të KPP-së, të pandehurit duhet të lirohen nga akuza se kanë kryer veprat: "rrezikim i trafikut publik me veprim apo mjete të rrezikshme", në shkelje të nenit 299 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 380 (1) të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe "shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm", në shkelje të Nenit 291 (1), (3) dhe (5) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 365 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

3.2. Lidhur me akuzën e "pjesëmarrjes në një grup që kryen vepër penale"

148. Neni 320 i KPK-së (Pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale) parashikon:

"(1) Kushdo që merr pjesë në një turmë të mbledhur, e cila me veprime kolektive e privon personin nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëmton pasurinë në përmasa të mëdha ose kryen vepra të tjera të shkeljeve të rënda apo tenton të kryejë vepra të tilla dënohet me burgim prej tre muajve deri në pesë vjet".

149. Neni 412 i KPRK-së (Pjesëmarrje në një turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi) parashikon: "1. *Kushdo që merr pjesë në turmën e mbledhur prej më tepër se tetë personave, e cila me veprime të përbashkëta e privon personin tjetër nga jeta, i shkakton lëndime të rënda trupore personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, shkakton dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë ose kryen vepra tjera të rënda të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim apo tenton të kryejë vepra të tilla, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet".*

150. Sipas dispozitës së vjetër, mendimi i përgjithshëm ishte se turma duhet të jetë më e madhe se shtatë (7) ose të paktën dhjetë (10) persona.

151. Megjithatë, ai parashikon gjithashtu se:

"Duke marrë parasysh, nga ana tjetër, se krijimi i një tubimi është shpesh një akt spontan dhe si pasojë nuk është i lidhur me një numër të pandryshueshëm të pjesëmarrësve [numri luhatet, rritet e ulët, në varësi të ecirsë së ngjarjeve], prandaj nuk është e këshillueshme të përcaktohet që më parë një numër i caktuar [i njerëzve], si prag,

në vend të kësaj, kjo duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur në çdo rast, duke marrë parasysh shumë rrethana".¹⁴³

152. Fusha e veprimit të kësaj dispozite është të dënojë organizimin e tubimeve, jo për krijimin e një grupi që kryen një pritë.

153. Zakonisht, tubimi është i rrezikshëm pikërisht për shkak se ai ka reagimet e veta që janë të pavarura nga reagimi i pjesëtarëve të tij.

154. Në këtë formë, tubimi është i ndryshëm nga një grup, që në përgjithësi është i kufizuar për sa i përket numrit të pjesëmarrësve, ka një vetëdije dhe është i organizuar. Tubimi i vërtetë është një turmë e paorganizuar [kaotike], megjithëse termi tubim/turmë mund të zbatohet edhe kur ekziston ka nivel i caktuar [më i vogël ose më i madh] rendi dhe të organizimi.

155. Kështu, formimi i vetë barrikadës, në këtë rast, është më afër një grupi sesa një tubimi ose turme reale për shkak të numrit të njerëzve dhe formës së organizuar në kushtet e të cilave ndodhi ngjarja.

156. Prandaj, në bazë të Kodit të vjetër, kjo Gjykatë nuk mund të përcaktojë se personat e pranishëm në barrikadë ishin të paktën 10. Në fakt, dëshmitari më i mbështetshëm në këtë lëndë deklaroi se në barrikadë ishin tetë persona dhe se në një farë distance atje ndodheshin edhe dy persona të tjerë për të parë.¹⁴⁴

157. Sipas Kodit të ri, ky element objektiv i akuzës penale është zvogëluar dhe është përcaktuar si **më shumë se tetë (8) persona**.

158. Edhe një herë, në këtë rast, Gjykata nuk mundi të përcaktojë se personat në barrikadë ishin më shumë se tetë (8). U provua se personat në barrikadë ishin rreth tetë vetë.

159. Prandaj, njëri element objektiv i dispozitës penale nuk u vërtetua dhe për këtë arsye të pandehurit duhet të lirohen nga akuza, sipas nenit 364 paragrafi (1) nën-paragrafi (1.3) të KPP-së, se kanë kryer veprën penale të "pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale", në shkelje të nenit 320 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, *pari materia* me nenin 412 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

IV. SHPENZIMET, KËRKESA PASURORE-JURIDIKE DHE KONFISKIMI

4.1. Kërkesa pasurore-juridike

¹⁴³ Shih Z. Stojanovic dhe O. Peric, "Neni 215", *Komentari i Kodit Penal të Serbisë dhe Kodit Penal të Malit të Zi*, Gazeta Zyrtare e RFJ Beograd (1996), faqe 290;

¹⁴⁴ Proces-verbal i Shqyrtimit Gjyqësor, 29 janar 2015, faqet 21-22, Shih Tab 1, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI III;

160. Të dëmtuarit u udhëzuan për të drejtën e tyre për të paraqitur kërkesë pasurore-juridike, në bazë të neneve 458, 459 dhe 460 të KPP-së. Një kërkesë e tillë u paraqit në ditën e fundit të shqyrtimit gjyqësor.¹⁴⁵ Sipas nenit 463 paragrafi (2) të KPP-së dhe duke marrë parasysh natyrën e aktgjykimit të pafajësisë, gjykata i udhëzon palët e dëmtuara se ato të mund të paraqesin kërkesë pasurore juridike në kontest civil.

4.2. Shpenzimet penale

161. Shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 450 paragrafi (2), nën-paragrafi (2.1.) deri në (2.5.) të KPP-së, shpenzimet e nevojshme për të pandehurit dhe shpërblimi dhe shpenzimet e mbrojtësve do të paguhen nga buxheti i Gjykatës, sipas nenit 454, paragrafi (1) të KPP-së.

*

Gjykata Themelore e Mitrovicës
P. Nr 59/2014

Kryetari i trupit gjykues i EULEX-it
Paulo Teixeira _____

Zyrtarja Ligjore e EULEX-it / Proces-mbajtëse
Vera Manuello _____

Mjet juridik: Të Pandehurit, mbrojtësit e tyre, Prokurori ose i Dëmtuari kanë 15 ditë nga marrja në dorë e këtij Aktgjykimi për të bërë ankesë, në bazë të neneve 380 paragrafi (1) dhe 381 paragrafi (1) të KPP-së. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën e shkallës së parë, në bazë të nenit 388 paragrafi (1) të KPP-së.

¹⁴⁵ Shih Tab 11, Dosja e Shqyrtimit Gjyqësor e Gjykatës, VËLLIMI V;